

Protestë

Reformat kalojnë përmes Almirit

Fq.5



DSK PRANON FAJIN

"E morëm me dhunë dëshminë e Ramadanit"

Fq.4




Takohet me drejtuesit e PSZH-së?

Fq.21



Koha

www.koha.mk



KOHA për enigma

Fq.11-14

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3307 · e shtunë e diel 3-4 mars, 2018

1°C | 11°C

15 DEN

FORUM

Parimi i harresës!



Jeta është dinamike që na shtyn që edhe gjërat që i kemi përjetuar si katarzë, t'i harrojmë shpejtë. Ku ishim djë, e ku jemi sot. Vetëm para një viti e ca, shteti përpëlitej në një krizë të thellë në përpjekje për ta detronizuar një pushtet të cilit i dolën këmbët përjashta. Një pushtet që u kap "me kërpesh" për dore, i cili në çdo vend demokratik do të kishte rënë kaheër me skandalin e parë, e jo më dhjetëra skandale korruptive e keqpërdorime të cilat e zhveshën nga PR-imazhi i ndër-tuar i ndershmërisë dhe drejtësisë. Vetëm falë strategjisë kokëfortë, ai pushtet vazhdoi agoninë e vet... Fq.10

GLOBI

SHBA-Rusi, një garë e re armësh

Fq.17

RAJON

Pas Ivanoviqit, në plan ishte të vritej presidentja kroate

Fq.16



BILALL KASAMI DHE AFRIM GASHI VAZHDOJNË BETEJËN NË GJYKATË

BESA NË DORË TË AVOKATËVE

Nga prononcimet zyrtare të dy zëdhënësve partiak, vërehet se forcat do ti matin përmes angazhimit të avokatëve gjatë procesit gjyqësor që është çështje ditësh se kur do të fillojë "beteja" pranë Gjykatës Themelore në Shkup

Fq.3

Deri në 2050 humb një qytet sa Kumanova

Shkup, 2 mars - Maqedonia deri në vitin 2050 do të humb 4.4 për qind të popullatës. Kjo me fjalë të tjera nënkupton se në 32 vitet e ardhme do të humbet një qytet i tërë si Kumanova. Ose popullata e Maqedonisë do të zvogëlohet nga 2 milion e 83 mijë në vitin 2017 në një milion e 991 mijë në vitin 2050. Sipas parashikimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shteti më i goditur nga humbja e popullatës

është Serbia që do të humb 33.2 për qind të popullatës apo një Beograd të tërë. Popullatë në Slloveni do të zvogëlohet për 23 për qind, ndërsa në Bullgari për 22 për qind. Shqipëria do të humb afër 3.6 për qind të popullatës apo nga 2 milionë e 930 mijë në 2 milionë e 825 mijë. Sipas projeksioneve i tërë rajoni do të ballafaqohet me zvogëlimin e numrit të popullatës, me përjashtim të Kosovës... Fq.7



EDITORIAL

BETEJAT E PAMBARUARA TË ARSIMIT



Emin AZEMI

Drita e diturisë, për të cilën u flijuan jo pak breza, do të ishte e mangët për të na kujtuar rrugën kah eci zhvillimi ynë, sikur sot të mos ishin plazmuar në shpirtndërtimin tonë disa nga vlerat e dijes dhe emancipimit. Beteja për të patur arsim kombëtar gjithmonë ishte shoqëruar me idenë madhore të Rilindësve, të cilët aksionin e tyre kulturor e politik e projektonin me formën e shkronjave të bukura të alfabetit të shqipes.

Dallgët e shekujve ishin munduar ti deformonin këto forma, duke nxjerrë jo rrallë në brigjet e kohës edhe trajta çoroditëse të ndërhyrjes arbitrare mbi autonominë arsimore të shqiptarëve. Duke lëvizur nga arabeskat e ngatërruara e deri te ftohtësia refuzuese e cirilicës, lavjerrësi etno-kulturor i shqiptarëve mudohej ta gjente Itakën e vet të prehjes, brenda plotnisë gjuhësore e shkrimore.

Pas shumë udhëtimesh të mundimshme, heronjtë e arsimit shqip arritën të sjellin në brigjet shqiptare edhe bankat e para ku do të cicërohej gjuha e ëmbël shqipe. Që nga Korça, Elbasani e deri në Dibër, Tetovë e Kumanovë pishtarët e diturisë krijuan skuadrën e madhe të arsimdashësve.

Sot, historinë tonë të zhvillimit do të mund ta matim me parimet që na ofron niveli arsimor i brezave. Një arsim i konsoliduar kombëtar nuk do të ishte në shkallën adekuate të kërkesave nëse ai nuk i nënshtrohet kriterëve të mirëfillta valorizuese dhe krahasuese. Vetëdija për të patur një arsim të shëndoshë buron në nevojën që progresi shoqëror të bazohet medoemos mbi selektimin pozitiv të kuadrove të pajisur me edukim të mirëfilltë shkencor e profesional.

Sfida e arsimit, është edhe sfidë e gjithë shoqërisë. Do të ishte e pafalshme që gjithë atë luftë brezash për të mbajtur gjallë arsimin shqip, përfshi edhe sakrificat titanike për themelimin e Universitetit të Tetovës, ta devalvonim duke mos ofruar një kondicion më dinamik në zhvillimin tonë arsimor.

Kuptimi për arsimin sot ka ndryshuar, bashkë me procesin e përgjithshëm të transformimeve shoqërore. Nëse në të kaluarën arsimi shqip identifikohet me qirinjtë e ndezur, që jo rrallë fikeshin nga erërat e egra barbare, sot ai duhet të jetë treguesi më i saktë që regjistron lëvizjet sejmike. Që të mos kemi dridhje të mëdha tektonike, është e domosdoshme ta konsolidojmë të sotmen dhe të ardhmen tonë me shtyllat e forta të edukimit dhe profesionalizmit Perëndimor.

Nëse në të kaluarën kemi fajësuar të tjerët për deformimet e ndryshme në arsim, sot e kemi ezauruar këtë mundësi. Në të shumtën e rasteve jemi vet ne ata që përcaktojmë kahet e zhvillimit dhe emancipimit, që nënkupton edhe dinamikën dhe performancën e një arsimit cilësor.

Parasegjithash duke i flakur mendësitë populiste për kuantitet, në dëm të kualitetit. Beteja për arsimin fillon në amfiteatro e mësonjëto dhe përfundon në pista të gjata të verifikimit të dijeve e përvojave akademike. Për të dalur të suksesshme këto beteja nevojitet një konsolidim më përmbytësor i arsimit shqip, duke iu ofruar mundësi dhe shanse kuadrove që në ambientin tonë sjellin kreativitet në qasje dhe dinamikë veprimi.

PROBLEMI I VETËM I MASH-it

"Disa Universitete private bëjnë shkelje të mëdha ligjore, por Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk i regjistron dhe nuk i sanksionon këto. I vetmi problem i sistemit arsimor në Maqedoni është emërimi i drejtorëve në shkollat fillore dhe të mesme në Gostivar...", shkruan në profilin e tij në Facebook, kryetari i Gostivarit, Arben Taravari, duke ironizuar me standardet e dyfishta të MASH-it për marrjen e kompetencave vetëm të udhëheqësve opozitar në komuna dhe institucione tjera.



POST-DEMOKRACIA, NJË LLOJ NEO-FEUDALIZMI

"Në Shqipëri e Kosovë shteti nuk i fton qytetarët të krijojnë a të prodhojnë, ndërkohë që do të duhej t'i nxiste. Përkundrazi, ka një zaptim të çdo fushe prej klikave e klaneve, që nga akademja, artet, shkencat, mediat, ekonomitë, ekologjitë, organizimet, vendimmarrjet - gjithçka e kontrolluar prej klikave respektive dhe e strukturuar si konflikt mes klikash që ishin, që janë dhe që duan të vijin. Klikat, synimi i të cilave është të grumbullojnë sa më shumë kapital real apo simbolik, janë të paineresuara që të ketë prodhim apo krijim vendas "atje poshtë" në secilën sferë, në popull. Madje janë kundër, sepse prodhimi e krijimi vendas do të ishte zhvillim i pavarur prej tyre, gjë që ua zbeh pushtetin. Klikat pra janë të interesuara vetëm për lloje të importit (import malli të huaj, import diplomash të huaja, import ekspertësh të huaj, import autoriteti, drejtësi, demokracie, estetike, etike, logjike të huaj). Klikat në secilën fushë luajnë rolin e doganës, secili import kalon në duart e tyre për 'validim'. Ndërkohë goditja liberale ndaj ndjenjave identitare, bashkë me shkatërrimin e programuar të aparatit shkollor dhe degjenerimin e rolit shoqëror të mësuesve, ka prodhuar qytetarë që nuk e shohin të arsyeshme të luftojnë për ta ndërruar realitetin e klikave dhe të klaneve. Injorantë ndaj gjithçkaje prej historisë e qytetërimit, individualistë të pandërgjegjshëm, që refuzojnë çdo përgjegjësi shoqërore e kundërshtojnë cilindo që rreket t'u mësojë diçka: shumë të rinj shohin si synim veç veten e vet, dhe si metodë për mbërritje emigrimin ose krimin, shpesh të dyja bashkë. Vërtet, post-demokracia është një lloj neo-feudalizmi, klikat kapëse të secilës fushë autonome janë të strukturuar me vasalitet e sinjorazh, janë territoriale e të pamëshirshme, ndërsa ata nën to, i ashtuquajtur "prekariat" pak gjëra ka ndryshe në rolin e vet politik, nga "fshatari pa tokë" në mos po edhe nga "bujkrobi". Ky neo-feudalizëm mund të rrëzohet ose nga një popull aktiv, ose nga një "dorë e fortë" që paraqet një vizion. Shumë vende që kohët e fundit kanë përjetuar uzurpimin e çdo sferë publike prej klikave korporative e oligarkike, më shpesh kanë zgjedhur "dorën e fortë" si rrugëdalje. Ndoshta për shkak se është mjet i provuar historik, në fakt në themel të thujse secilit modernizim e demokratizim që gëzojnë shtetet perëndimore sot, qëndrojnë periudha 'autoritarizmi vizionar", shkruan në profilin e tij, Arbër Zaimi.



MEDIACitate

Pas takimit me kryeministrat e rajonit në Sofje të Bullgarisë, kryeministri Rama ka thënë, operacioni i fundit anti-drogë ka ardhur si rezultat i agjencive ligjzbatuese shqiptare. Rama duke folur nga Sofja pas takimit me zyrtarët e BE-së Juncker dhe Mogherini, tha se 613 kg kokainë kaluan pa problem portet e Bashkimit Europian dhe u kapën në Shqipëri. Presim një rekomandim pozitiv nga BE dhe pastaj dhe një përgjigje pozitive nga vendet anëtare. Është e qartë që duhet të punojmë intensivisht nga kjo periudhë sa i përket vendeve anëtare pasi kështu funksionon ky proces. Por është po ashtu e qartë se ka një mirëkuptim të gjerë lidhur me hapat e rëndësishëm që ka bërë Shqipëria dhe mbase vlen të nënvizohet në fund se edhe operacioni më i fundit nga agjencitë tona ligjzbatuese, hetimi doganor dhe policia e shtetit me mbështetjen e prokurorisë pati një jehonë shumë pozitive dhe u vlerësua me pozitivet maksimal duke pasur parasysh se ngarkesa e kapur përbën jo vetëm një sasi që është më e madhe e kapur ndonjëherë prej nesh por një sasi që përpara sesa të vijë në vendin tonë ka kaluar në portet e BE dhe faktikisht u ka shpëtuar kontrolleve. Sipas Ramës, "vetëdija dhe nënvizimi i kësaj vetëdije se ky operacion ishte mirëfilli i agjencive tona ligjzbatuese pa një sinjalizim nga partnerët. Është krejt e natyrshme që ne të punojmë vijimësisht me partnerët, është krejt e natyrshme që operacionet të jenë frut i bashkëpunimit me partnerët por në këtë rast është treguar gaditshmëri dhe integritet i lartë i forcave tona të angazhuara në luftën kundër trafikëve. Ajo që vlen të theksohet në këtë rast është gatishmëria e lartë e forcave tona në terren në këtë përballje të fortë kundër krimin të organizuar dhe trafikantëve të çdo lloji. Është e qartë se faza e parë e mbyllur me sukses për të çrrënjësuar kanabisin tanimë ja ka lënë vendin fazës së dytë ku lufta jone vjen duke u përshkallëzuar, gatishmëria jonë duke u rritur dhe patjetër dhe aftësisë e agjencive tona ligjzbatuese duke u provuar në terren me rezultate konkrete".

(fokus.bg, 2 mars)

NËSE NUK E KENI DITUR...

A EDINISEVJOSA KA QENË NJË LUMI SHENJTË?

Lumi Vjosa, ashtu si Nili e lumenjtë tjerë janë të mitizuar. Nga tërë lumenjtë e Shqipërisë, vetëm Vjosa është quajtur Lumi i Shenjtë. Për Vjosën janë thurur mjaft legjenda. Gryka e Vjosës ishte jo vetëm një strehim i sigurt për anijet, të cilat mund të hynin deri afër mureve rrethuese të Apolonisë, por edhe për t'u mbrojtur nga armiqtë. Me të drejtë shumë historianë e kanë quajtur "jetëdhënëse". Ndërmjet skulpturave të shumta, të ekspozuara në Pavijonin e Lashtësisë në Muzeun Historik Kombëtar, të bën përshtypje ajo që i kushtohet lumit Vjosa. Vjosa është

personifikuar në skulpturë nëpërmjet figurës së një plaku të shtrirë e të mbështetur në krahun e djathtë, me flokë deri te supet, me mjekër të dendur. Skulptura është në gur të bardhë, 49 cm e lartë, 70 cm e gjerë. I përket shek. III para Krishtit, zbuluar në Apoloni. Paraqitja antropomorfe e Vjosës tregon se ky lumi ka qenë i begatë dhe luginat pranë tij, pjellore. Ajo personifikohet me një perëndi. Gjymtyrët e zgjatura në formë valëzimi të kësaj perëndie, ku skulptori nuk ka qartësuar detajet anatomike, simbolizojnë dallgët e lumit Vjosa.

KASAMI DHE GASHI VAZHDOJNË BETEJËN NË GJYKATË

BESA NË DORË TË AVOKATËVE



Nga prononcimet zyrtare të dy zëdhënësve partiak, vërehet se forcat do ti matin përmes angazhimit të avokatëve gjatë procesit gjyqësor që është çështje ditësh se kur do të fillojë "beteja" pranë Gjykatës Themelore në Shkup

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 2 mars- Lëvizja BESA me kryetar Bilall Kasamin dhe ajo me kryetar Afrim Gashin janë në fazën e fundit të përgatitjeve teknike para se të ballafaqohen në gjykatë lidhur me atë se cili krah e ka legalitetin për të vepruar më tutje nën sintagmën "Lëvizja BESA". Nga prononcimet zyrtare të dy zëdhënësve partiak, vërehet se forcat do ti matin përmes angazhimit të avokatëve gjatë procesit gjyqësor që është çështje ditësh se kur do të fillojë "beteja" pranë Gjykatës Themelore në Shkup. Abdush Ymeri nga krahu i Kasamit thotë se shumë shpejtë do të përcjellin deri tek Gjykata vendimet që dolën nga Kongresi I parë zgjedhor partiak. Për momentin, thotë ai, po përgatitet dosja nga avokatë që ka angazhuar partia. "Nuk do t'i lëmë asgjë rastit, përveç që do i përcjellim vendimet që mori Kongresi i parë zgjedhor i Lëvizjes BESA, kemi angazhuar dhe avokatët që të përgatisin një dosje me të gjitha dokumentet valide të partisë. Në rast se do të kemi proces gjyqësor, ne jemi detyruar të përgjigjemi me gjitha shkresat zyrtare të partisë që mos t'i japim asnjë shkas dikujt të thirret në emër të Lëvizjes BESA

pas kësaj", thotë për gazetën KOHA Ymeri. Nga krahu tjetër, duke pretenduar se vazhdojnë të kenë shumicën - tashmë janë të sigurt se do të bëjnë dy padi - një ndaj Bilall Kasamit për thyerje të rregullave partiake dhe tjetra për keqpërdorim të vulave zyrtare. "Është procedurë për të cilën nuk kemi çka komentojmë. Avokatët e kanë këtë në dorë dhe derisa zgjat procesi, nuk dëshirojmë të paragjykojmë. Edhe pse, ritheksojmë, dëshmitë se nga është shumica janë në anën tonë. Gjithsesi të presim vendimin e gjykatës pas padive që do t'i bëjmë kundër Bilall Kasamit. Njëra për thyerje të rregullave statusore të partisë ndaj Kasamit me që nuk ka respektuar vendimet e shumicës, dhe tjetra për keqpërdorim të vulave zyrtare të partisë, për të cilat kemi folur më herët qysh personi Bilall Kasami pa u mbajtur asnjë mbledhje, ka shkarkuar dhe ndërruar disa kryetarë degësh", thotë Orhan Murtezani, zëdhënës i Lëvizjes BESA me kryetar Afrim Gashin. Ai thotë se nga partia presin që Gjykata të merr për bazë veprimet dhe e vendimet e shumicës sa i përket aspektit procedural dhe juridik. Murtezani flet edhe për hyrjen e mundshme në Qeveri të partisë së tij, me që siç thotë ai,

ABDUSH YMERI

Përveç që do i përcjellim vendimet që mori Kongresi i parë zgjedhor i Lëvizjes BESA, kemi angazhuar dhe avokatët që të përgatisin një dosje me të gjitha dokumentet valide të partisë. Në rast se do të kemi proces gjyqësor, ne jemi detyruar të përgjigjemi me gjitha shkresat zyrtare të partisë

ORHAN MURTEZANI

Është procedurë për të cilën nuk kemi çka komentojmë. Avokatët e kanë këtë në dorë dhe derisa zgjat procesi, nuk dëshirojmë të paragjykojmë. Edhe pse, ritheksojmë, dëshmitë se nga është shumica janë në anën tonë. Gjithsesi të presim vendimin e gjykatës pas padive që do t'i bëjmë kundër Bilall Kasamit

kryeministri Zoran Zav gjatë takimit me kryetarin Afrim Gashin ka shprehur vullnetin e tij që Lëvizja BESA të përfshihet në Qeveri. "Ajo që ka rëndësi është fakti se si kryetari Gashi ashtu edhe kryeministri Zaev shprehën vullnet të veprojnë në të ardhmen së bashku në Qeveri. Si do të shkojë punë më tutje, a do të kemi ekip negociator apo do të autorizohet kryetari Gashi të zhvillojë biseda me kryeministrin për ndarjen e resorëve qeveritar, organet e parisë do të vendosin shumë shpejtë", tha Murtezani. Në lidhje me participimin në Qeveri ka disponim edhe nga Lëvizja BESA me kryetar Kasamin. "Shumë shpejtë do t'ju informojmë nëse do të ketë takim kryetari Bilall Kasami me kryeministrin Zoran Zaev. Ende nuk kemi ndonjë datë zyrtare. Me LSDM-në dhe me kryeministrin Zoran kemi qenë transparent, kemi pasur takim në nivel liderësh edhe më herët. Takimet do të vazhdojnë, me rëndësi që Lëvizja BESA siç ka bërë më herët, duke e përkrah Qeverinë në lidhje me agjendat reformues, është e gatshme edhe të merr përgjegjësi duke qenë pjesë e Qeverisë reformatore", thotë Abdush Ymeri, zëdhënës i Lëvizjes BESA.

Tanturovski nuk dorëzohet, thotë se nuk jep dorëheqje

Shkup, 2 mars - Kryetari i Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK), Igor Tanturovski thotë se nuk ndjen kurrfarë përgjegjësie, për shkak se në asnjë mënyrë nuk është theksuar në raportet revizore dhe nga këto arsye - nuk ka për qëllim të japë dorëheqje nga funksioni. Konsideron se rasti është instruktuar. Raporti revizor, potencoi Tanturovski, ka qenë për përdorim të brendshëm me rekomandime se si të tejkalohen mangësitë e konfirmuara, ndërsa nxjerrja e tij në opinion ka për qëllim vetëm të diskreditohej anëtarët dhe Komisioni si institucion. "Ajo që u transmetua nga një medium, është parafrazim i asaj që me të vërtetë shkruan në dokument. Është hyrë në hollësi që absolutisht nuk kanë lidhje me konsistencën e gjithë dokumentit. Janë nxjerrë vetëm segmente", thotë Tanturovski. Ai garanton se në institucionin me të cilin ai udhëheq, nuk ka korrupsion. Nëse ka pasur parregullsi, potencoi Tanturovski, ato është dashur t'i theksojë edhe Shërbimi për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta i Qeverisë së RM-së, i cili, siç tha, e udhëheq gjithë kontabilitetin dhe t'i parandalojë pagesat eventuale. Nuk shikon mënyrë, si dhe në çfarë baze Parlamenti mund t'i shkarkojë anëtarët e KSHPK-së. Kjo, theksoi Tanturovski, është përkrahur qartë në Ligjin për pengim të korrupsionit. "Dëgjova deklaratë të nënkryetares së Parlamentit, Frosina Tashevska Remenski se do të ngrenë ndonjë procedurë. Unë sinqerisht nuk e di se cila do të ishte ajo procedurë dhe se si do ta bëjnë këtë", thotë Tanturovski, duke shtuar se në njëfarë mënyre ndjen se ky është revanshizëm politik për atë që si institucionin e kanë ndërmarë në momentin e kaluar.



Shkup, 2 mars - Ahmeti është politikan i mençur dhe me përvojë, tha kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickoski para takimit të nesërm me të. Ai në një intervistë në emisionin "Samo vistina" të Kanal 5 tha se pret që ky takim të jetë fillim i shoqërisë së re, shkruan Nova TV, transmeton Portalb.mk. "Ahmeti

MICKOSKI PARA TAKIMIT ME AHMETIN

AI ËSHTË POLITIKAN I MENÇUR DHE ME PËRVOJË

është politikan i mençur dhe me përvojë. Unë si më i ri ndoshta do të mësoj ose do të marr ndonjë specifikë pozitive nga ajo bisedë. Absolutisht e respektoj si politikan dhe si njeri. E di se nga ajo bisedë do të marrim të dy benefite pozitive për partitë tona dhe për Republikën e Maqedonisë. Pres bisedë konstruktive dhe kuptimplote të dy miqve që tani po njihen dhe shpresoj se kjo do të bëhet praktikë e jona dhe në të ardhmen që të kemi

takime më të shpeshta", tha Mickoski. Mickoski tha se nuk e konsideron BDI-në për armik politik, veçanërisht pas vendimit që nuk koalicioni me VMRO-DPMNE-në pas zgjedhjeve parlamentare në dhjetor të vitit të kaluar. "Nuk e konsideroj për armik, si kundërshtar politik ndoshta, sepse është pjesë e qeverisë në të cilën ne jemi edhe kundërshtar politik", shpjegoi Mickoski. Sipas analistëve, ky ndryshim në retorikën e VMRO-

DPMNE është një reflektim i pozitës së partisë. "Ky është reflektim i kapaciteteve të tyre për koalicion, që janë realisht të reduktuar ndoshta në zero. Dhe unë mendoj se ky është në atë drejtim, ai mundohet ta ngritë kapacitetin e partisë të cilën e drejton, që e kanë konfirmuar edhe ata si problem", tha analisti Musliu. Musliu tha se është e paqartë se si mund të flasin rreth ligjit të gjuhëve për të cilin VMRO-DPMNE ka ngritur 35 000 amen-

damente, ndërsa nga BDI refuzojnë çdo ndërhyrje. "Për ne, puna e Ligjit të gjuhëve është përfunduar, për të cilin janë dakorduar edhe nga VMRO-DPMNE me 29 janar", thonë nga BDI. Nga partia e BDI-së thonë se në takim me Mickoskin nuk do të hapet çështja e ligjit të gjuhëve. Siç u njoftua edhe më parë, kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickoski, sot do të takohet me kryetarin e BDI-së, Ali Ahmeti.

OSMANI TAKOI NDIHMËS- SEKRETARIN E PËRGJITHSHËM TË NATO-s Integrimi në BE dhe NATO, garanci për stabilitetin e Evropës

Shkup, 2 mars - Zëvendëskryetari i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, të premtën në hapësirat e Sekretariatit për Çështje Evropiane, mbajti takim të përbashkët me Alejandro Alvargonzales, ndihmës-sekretar i Përgjithshëm i NATO-s për Çështje Politike dhe Siguri Politike dhe Maçej Popovski, zëvendësudrejtor i Përgjithshëm për Politikë Fqinjësore dhe Negociata për Zgjerim pranë Komisionit Evropian. Në takimin e përbashkët, thuhet në kumtesën e Kabinetit të Osmanit, u diskutuan aspiratat evropiane të Republikës së Maqedonisë, në kontekst të rekomandimeve të cilat i përmban Strategjia e re e Komisionit Evropian për zgjerim me vendet e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2025.

"Ndodhemi në një periudhë, që mund të thuhet, periudhë historike, kur konsensusi nacional dhe shoqëror është i domosdoshëm që përfundimisht ta mbyllim çështjen e BE-së dhe NATO-s", theksoi Osmani, duke potencuar mesazhet e Strategjisë së Komisionit Evropian, që me saktësi i përvijojnë për vendet e Ballkanit Perëndimor deri në anëtarësimin me të drejtat të plota. Në vazhdim Osmani referoi edhe për gjendjen e implementimit të Planit 3-6-9, posaçërisht në pjesën e reformave të sistemit gjyqësor, reformat në shërbimet e sigurisë, si dhe reformat në administratën publike. "Ekziston një optimizëm i qartë evropian, që paraqet një nxitje të rëndësishme për Qeverinë, por edhe për gjithë shoqërinë, të cilët në përgjithësi janë përkushtuar integriteteve euroatlantike të Republikës së Maqedonisë", shtoi Osmani. Duke komentuar perspektivat evropiane dhe euro-atlantike të rajonit, bashkëbiseduesit ranë dakord se vetëm një Ballkan Perëndimor i sigurt, stabil dhe i përparuar si pjesë e familjes evropiane parqet garanci për ardhmërinë, stabilitetin dhe sigurinë e Evropës në tërësi.

Në mesin e shumë detajeve, të cilët e vërtetojnë faktin se të akuzuarit në rastin e "Sopotit" kanë qenë të pafajshëm, inspektorët e DSK-së kanë thënë se gjatë bastisjeve të shtëpive të të akuzuarve shqiptarë, nuk është gjetur asnjë lloj materie eksplozivi, asnjë plumb apo ndonjë dëshmi më e vogël që i lidhë të akuzuarit me vrasjen e ushtarëve polak

Koha

Omer XHAVERI

Shkup, 2 mars - Gjashtë inspektorë të lartë të policisë sekrete, të implikuar në rastin e "Sopotit", të premtën para Gjykatës Penale të Shkupit (GJPSH) kanë pranuar se në mungesë të fakteve, padrejtësisht e kanë mbajtur dëshmitarin e koduar Ramadan Bajrami për disa ditë të fshehur, pa e ditur vendndodhjen. Angazhimi i tyre në detyra për kundërzbulim dhe terrorizëm ishte shkaku kryesor se pse mediat dhe publiku, në seancën e parafundit për "Sopotin", nuk u lejua të prezantojnë. Burime të gazetës KOHA brenda GJPSH-së vërtetuan se gjatë rrëfimit të ngjarjeve, dëshmitarët Robert Ivanovski, Boban Stojanovski, Ilija Smilevski, Mile Vellkovski, Mile Andonovski dhe Marjan Nikollovski, që të gjithë punonjës të DSK-së, e kanë pranuar se dëshmitarit të mbrojtur, Bajrami të gjitha deklaratat i janë marrë nën presionin e dhunës. Në lokacione të ndryshme, në qytetin e Strumicës, siç kanë deklaruar nëpunësit e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërz-

UDBASHËT E DSK-së PRANOJNË FAJIN

"E MORËM ME DHUNË DËSHMINË E RAMADANIT"



Koka e gjithë operacionit kundër shqiptarëve të Sopotit flitet të jetë Marjan Nikollovski, punonjës i lartë i DSK-së në Kumanovë, ndërkohë që vjen pikërisht nga Sopot. Edhe më herët, gjatë seancave të mëparshme, të akuzuarit e Sopotit e kishin apostrofuuar pikërisht Nikollovskin si montuesin kryesor të rastit, ndërsa skenari i shërbimit sekret të asaj kohe i ishte menduar të largojë forcat e NATO-s nga rripi kufitar Maqedoni-Serbi në këtë pjesë të vendit

bulim, dëshmitari i vetëm në rastin e "Sopotit" është marrë në pyetje, gjegjësisht ato kanë pranuar se pa respektuar procedurat ligjore, dëshmitari në fjalë është arrestuar. Në mesin e shumë detajeve, të cilët e vërtetojnë faktin se të akuzuarit në rastin e "Sopotit" kanë qenë të pafajshëm, inspektorët e DSK-së kanë thënë se gjatë bastisjeve të shtëpive të të akuzuarve shqiptarë, nuk është gjetur asnjë lloj materie eksplozivi, asnjë plumb apo ndonjë dëshmi më e vogël që i lidhë të akuzuarit me vrasjen e ushtarëve polak.

Fjalët përfundimtare, (pas rifilimit të procesit gjyqësor për "Sopotin", kësaj radhe i përfaqësuar nga Prokuroria Speciale Publike) është paraparë të jepen me datë 19 mars. Pala mbrojtëse e të akuzuarve për

rastin "Sopot", të cilët për 15 vite me radhë bredhin gjykatave të Maqedonisë në kërkim të drejtësisë, tha se pas pranimit të aktgjykimit, prokuroria relevante duhet të inicioj procedurë penale për vërtetim të përgjegjësisë dhe shkeljeve që i kanë kryer nëpunësit e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim. Megjithatë, siç nënvizuan ata, edhe njëherë duhet të shqyrtohet mirë mundësia ligjore e cila e lejon apo jo ngritjen e një procedure të tillë, pasi kanë kaluar 15 vite nga rasti dhe i njëjtit mund të konsiderohet i vjetruar.

Koka e gjithë operacionit kundër shqiptarëve të Sopotit flitet të jetë Marjan Nikollovski, punonjës i lartë i DSK-së në Kumanovë, ndërkohë që vjen pikërisht nga Sopot. Edhe më herët, gjatë

seancave të mëparshme, të akuzuarit e Sopotit e kishin apostrofuuar pikërisht Nikollovskin si montuesin kryesor të rastit, ndërsa skenari i shërbimit sekret të asaj kohe i ishte menduar të largojë forcat e NATO-s nga rripi kufitar Maqedoni-Serbi në këtë pjesë të vendit.

Reformat e drejtësisë para zyrtarëve të NATO-s

Shkup, 2 mars - Proceset reformuese të cilat i zbaton Qeveria për integrimin e Republikës së Maqedonisë në NATO dhe fillimi i negociatave me BE-në, ka qenë temë e bisedës të premtën të ministrit të Drejtësisë, Bilën Saliji me Ndihmëssekretarin e Përgjithshëm të NATO-s për Çështje Politike dhe Politikë të Sigurisë -PASP, Alejandro Alvargonzales, Zëvendësudrejtorin e Përgjithshëm për Politikë Fqinjësore dhe Negociata për Zgjerim pranë Komisionit Evropian, Maçej Popovski dhe shefin e Delegacionit të BE-së, Samuel Zbogor. Gjatë takimit me përfaqësuesit e lartë të NATO-s dhe të Komisionit Evropian, siç kumtoi Ministria e Drejtësisë, Saliji ka prezantuar një pjesë të reformave dhe nismave të Ministrisë dikasteriale me të cilat kontribuohet për këtë proces të rëndësishëm për vendin dhe për aspiratat e saj euroatlantike. Duke u shprehur falënderim përfaqësuesve të lartë evropianë për mbështetje, Saliji ka theksuar se është i



gatshëm në emër të institucionit që e udhëheq të përmbushen kërkesat e BE-së për krijimin e një sistemi ligjor në pajtim me standardet evropiane. Takimi që u mbajt në Ministrinë e Punëve të Brendshme, me përfaqësuesit e kësaj pjesë, u mbajt në frymën e bashkëpunimit dhe gatishmërisë që të kontribuohet në mënyrë konkrete dhe drejtpërdrejtë drejtë të procesit të anëtarësimit në NATO dhe BE. Saliji në takim i ka theksuar nismat konkrete të Ministrisë së Drejtësisë në këtë drejtim. Ai, mes tjerash ka theksuar se një prej

reformave kyçe në periudhën e fundit është Strategjia për reforma në sektorin e gjyqësisë me Planin e veprimtimit 2017-2022, i cili përfshin masa dhe aktivitete për vendosjen e sistemit të pavarur, të besueshëm, dhe profesional gjyqësor në Republikën e Maqedonisë. Ka theksuar edhe Ligjin e miratuar për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për konfirmimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për konfirmimin e përgjegjësisë disiplinore për gjykatës Si pika tjera të rëndësishme, ministri Saliji i ka theksuar edhe propozim-ligjin për

ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përpilimin e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje të dëshmitarëve, është përfunduar pjesa e parë për mbikëqyrje mbi funksionimin e sistemit AKMIS në Gjykatën Themelore Shkupi 1, Gjykatën e Apelit Shkup dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, ku u përpilua edhe raport me konkluzione definitive për keqpërdorime të mundura, miratimin e Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje të informatorëve, në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Veneçias, në proces të miratimit gjendet edhe Propozim ligji për ndihmë juridike falas, i cili mundësoi dhe e avancoi të drejtën që individët të kenë të qasje në mbrojtje të drejtë dhe korrekte, duke siguruar mbështetje financiare nga shteti, njëherësh u miratua edhe Strategjia për teknologji informatike dhe komunikimit në gjyqësi.

GJYQËSORI JOPROFESIONAL, "ARMA" E BOBAN ILIQT NË SHITJE



REFORMAT KALOJNË PËRMES ALMIRIT

Organizatorët e protestës theksuan se posedojnë informacione të sigurta se pikërisht kryeprokurori Lubomir Jovevski është personi i cili e ka vendosur nënshkrimin për rikualifikim të veprës penale kundër vrasësit Boban Iliq

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 2 mars - Sistemi gjyqësor joprofesional, i padrejtë dhe selektiv, vazhdon të funksionoj edhe kur në pushtet është "qeveria reformatore" e kryeministrit, Zoran Zaev. Ky është qëndrimi i sektorit civil, i cili të premten para Prokurorisë Republikane të Maqedonisë e zhvilloi protestën e radhës, kundër nismës për rikualifikim të veprës penale nga "vrasje" në "aksident komunikacioni", në rastin e Almir Aliut. Aktivistët qytetarë Anita Latifi, Visar Vishka dhe Dijana Toska, gjatë fjalimit të mbajtur para protestuesve, thanë se përderisa i gjithë opinioni është në pritje të shpalljes së aktgjykimit kundër vrasësit Boban Iliq, Prokuroria e Kumanovës dhe organet e rendit kanë lejuar që "arma e vrasjes", vetura mercedes, të dalë në shitje. Sipas tyre, procesi gjyqësor kundër vrasësit Boban Iliq, i cili tashmë ka filluar nga e para, paraqet shembullin klasik se si nuk duhet të veprojnë një sistem gjyqësor, respektivisht një shtet i cili në Kushtetutën e tij, i garan-

ton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. "Lëshimet e bëra në procedurën hetuese për vrasjen e vogëlushit Almir Aliu, janë burimi kryesor i tërë kësaj gollgote gjyqësore që e përjeton familja Aliu dhe në përgjithësi sistemi gjyqësor në vend. Prokuroria e Kumanovës, me këtë rast, në vend se të bëjë konfiskimin e automjetit që ka shërbyer si armë për vrasjen e tmerrshme të katërvjeçarit Almir, ajo të njëjtin ia ka kthyer familjes së të akuzuarit", tha organizatorja e protestës, Anita Latifi. Procedura hetuese e mangët, eliminimi i provave, animi i Prokurorit Publik gjatë kohës kur lëndë ka "shëtatur" nga Prokuroria e Kumanovës te ajo e Larta - dhe më në fund të Prokuroria Republikane, sipas organizatorëve të protestës, paraqesin shkelje të rënda ligjore. Pas mos respektimit të procedurave gjyqësore dhe para se gjithash të transparencës, në protestën e organizuar të premten në Shkup, para Prokurorisë Republikane, edhe njëherë u kërkua përjashtimi i prokurores kontroverze, Suzana Kusigerska. Në kohën kur Qeveria e Maqedonisë paralajmëron dhe angazhohet për reformimin e plotë të sistemit gjyqësor në vend, avokatët dhe ekspertët e fushës juridike theksojnë se

rikualifikimi përfundimtar i veprës penale në rastin e Almir Aliut, do ti japë goditja fatale, përpjekjeve të kësaj qeveria, për zbatimin e reformave në drejtësi.

Ndryshe, organizatorët e protestës theksuan se posedojnë informacione të sigurta se pikërisht kryeprokurori Lubomir Jovevski është personi i cili e ka vendosur nënshkrimin për rikualifikim të veprës penale kundër vrasësit Boban Iliq. Aktivisti qytetar, Visar Vishka, mes tjerash tha se e gjithë kjo procedurë për momentin mbahet e fshehur dhe nuk është publikuar, me të vetmin qëllim, që kur të afrohet fundi i këtij procesi gjyqësor, prokurorja Kusigerska, me leje të Prokurorisë Republikane, do të kërkojnë rikualifikim të rastit.



Aktivisti qytetar, Visar Vishka, mes tjerash tha se e gjithë kjo procedurë për momentin mbahet e fshehur dhe nuk është publikuar, me të vetmin qëllim, që kur të afrohet fundi i këtij procesi gjyqësor, prokurorja Kusigerska, me leje të Prokurorisë Republikane, do të kërkojnë rikualifikim të rastit

Me këtë rast, ai i apeloj kryeprokurorit Jovevski që nëse këto deklarata janë të pavërteta, i njëjti të del publikisht dhe ta prezantojë vendimin, i cili siç tha Vishka, është miratuar më 27 dhjetor të vitit të kaluar, ose tre muaj pas shkarkimit të Marko Zverlevskit. Sidoqoftë, për protestuesit dhe organizatorët e kësaj revolte qytetare, sistemi gjyqësor në vend vazhdon ta dëshmojë veten se kryekëput është i njëanshëm dhe i partizuar.

KRONIKË

Nga një banesë vidhen aksesorë ari dhe orë dore

Një person i panjohur, të enjten mbrëma ka kryer vjedhje të rëndë në banesën e L.J. (62) nga Shkupi me çka ka marrë sasi të madhe të aksesorëve të arit, dy orë dore të femrave Kasio dhe disa komplete të aksesorëve Svarovski, dhe më pas është larguar nga vendi i ngjarjes. MPB-ja informon se autori i veprës ka përfituar në mënyrë të paligjshme një pasuri me vlerë prej 947.000 denarëve. Ai duke përdorur një mjet special e ka hapur derën e hyrjes dhe ka hyrë në banesë. Po ndërmerren masa për gjetjen e autorit të veprës dhe zbardhjen e rastit.

"Asani më sulmoi vetëm verbalisht"



Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, dje u takua me nëpunësen policore Jasmina Janaçkovska, me qëllim që personalisht të informohet për incidentin e djeshëm. Funksonari i BDI-së, Beqir Asani, dje e ka sulmuar nëpunësen policore, gjatë marrjes së automjetit të tij me automjetin special karrotrec. Ajo, siç theksohet në kumtesën e MPB-së, është sulmuar verbalisht, derisa i ka kryer detyrat e saj të punës në udhëkryqin në bulevardin "Goce Delçev" dhe rrugën "Filipi i Dytë" në Shkup. Gjatë marrjes së automjetit motorik "Lan Rover" me targa të Shkupit me automjetin special karrotrec, Janaçkovska ishte sulmuar verbalisht nga Asani, i cili është pronar i automjetit, shtohet në kumtesë. "Gjatë kryerjes së kontrollit rutinor pashë disa automjete të cilat ishin parkuar në mënyrë të parregullt. Sipas procedurës, automjetet i fotografuam dhe filluam me marrjen e tyre. Në atë moment erdhi një person i panjohur për të cilin më vonë kuptova se bëhet fjalë për B.A. dhe filloi të bërtasë. Menjëherë, thirra përforcim dhe erdhën një numër i madh i nëpunësve policorë", e informoi Janaçkovska, ministrin. Në pyetjen e ministrit nëse ka pasur çfarëdo lloj kontakti fizik dhe pse nëpunësja policore ka kërkuar ndihmë mjekësore Janaçkovska, sqaroi se me personin B.A. ka pasur vetëm grindje verbale, megjithatë gjatë tërheqjes nga vendi i ngjarjes ajo e kishte goditur dorën e majtë tek karrotreci, por nuk ka marrë lëndime serioze, që është konstatuar edhe gjatë kontrollit mjekësor në SPQ "Shën Naumi i Ohrit". Ministri Spasovski i dha mirënjohje Janaçkovskës, për veprimin e saj profesional dhe theksoi se i inkurajon të gjithë nëpunësit policorë të veprojnë në mënyrë joselektive dhe profesionale, në pajtim me autorizimet e tyre ligjore. (O.Xh)

VJEDHJE E ARMATOSUR NË GOSTIVAR

Në mes të ditës plaçkitet Hallk Bank

Shkup, 2 mars - Një person i armatosur me pistoletë, rreth orës 12 ka hyrë në ekspoziturat e Hallk Bank në Gostivar dhe ka marrë shumë të madhe të parave. Sipas të gjitha gjasave në vjedhje i ka ndihmuar së paku edhe një person tjetër. Sipas gjetjeve fillestare të hetimit të cilën e bënë nga SPB Tetovë, një burrë i moshës së mesme me kapelë në kokë dhe i sulmuar me pistoletë ka hyrë në

ekspoziturat në rrugën "Goce Delçev", në afërsi të qendrës së kulturës. Me pistoletë të drejtuar drejt njerit prej të punësuarve i është kërcënuar me jetë dhe ka marrë rreth një milion denarë. Në shpejtësi pastaj është larguar dhe ka hyrë në një veturë të cilën e voziste një peron tjetër. Policia e Gostivarit po kryen ekspertizë dhe po punon në gjetjen e autorit të veprës.



Në listën e shkollave me nevoja urgjente për zgjerimin e hapësirave, kryetari i Komunës së Çairit, Visar Ganiu numëron shkollën fillore "Ismail Qemali" dhe "Liria", të cilat nuk gjenden në programin e investimeve kapitale të MASH-it për vitin 2018

KËRKOHEN ZGJIDHJE AFATSHKURTE DHE AFATGJATE PËR SHKOLLAT E ÇAIRIT

NEVOJË URGJENTE PËR ZGJERIMIN E DY SHKOLLAVE

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 2 mars - Mungesa e hapësirave shkollore në Komunën e Çairit ka arritur në pikën kritike dhe duket se nuk ka mbetur as kohë për të shkuar në zgjidhjet afatgjate të problemeve. Deri në ndërtimin e shkollave të reja, që padyshim se janë nevoja prej të cilave vështirëse do të mund të shpëtojnë organet kompetente, Komuna e Çairit do të duhet të gjejë zgjidhje të shpejtë dhe afatshkurtër për shkolla të caktuara. Nëse deri vitin e ardhshëm shkollor 2018/2019 nuk zgjerohen hapësirat e shkollës fillore "Ismail Qemali" në lagjen "Fusha e Topanës", shkolla nuk do të jetë në gjendje fizike të sigurojë klasë për të gjithë nxënësit e saj. Vitin 2017/2018 kjo shkollë e nisi me 1460 nxënës, të shpërndarë në 20 klasë të rregullta dhe 4-5 të improvizuara. Në shumë paralele, numri i nxënësve është me nga 36, 37 dhe 38 në klasë, ndërsa duke parë tendencën në rritje të numrit të nxënësve në këtë lagje - nevoja për të ofruar zgjidhje hapësirore, sikurse thotë kryetari i Komunës së Çairit,



Visar Ganiu, është urgjente.

"Në të kaluarën është punuar mjaft për përmirësimin e infrastrukturës arsimore në Komunën e Çairi. Janë ndërtuar objekte për shkollat 'Kongresi i Manastirit' dhe 'Adem Jashari' dhe është investuar në përmirësimin e kushteve. Por, për shkolla, asnjëherë nuk është mjaft të punohet dhe të investohet. Është një sferë e cila kërkon të jetë në hap me zhvillimin teknologjik dhe modernizimin e shoqërisë në përgjithësi", thotë Ganiu. Por përtej

këtyre premisave, ai është koshient edhe për mungesën e kushteve elementare në disa shkolla, konkretisht për mungesën e klasave për mësim. "Në disa shkolla kemi vërtetë problem me mungesën e hapësirave për mësim, sidomos në SHF 'Ismail Qemali' dhe SHF 'Liria', për të cilat kemi plane zgjerimi", shprehet Ganiu. Ai është optimist se të dyja këto shkolla do ta presin vitin e ardhshëm me hapësira të reja të zgjeruara, pavarësisht se të njëjtat nuk janë pjesë e programit

të investimeve kapitale të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH) për vitin 2018. Zëvendësministri i Arsimit, Arbër Ademi, numëron dy shkolla të tjera si pjesë të Programit të investimeve kapitale të këtij viti, konkretisht shkollën e nxënësve me nevoja të posaçme "Idnina" dhe SHF "Vasil Gllavinov" në Komunën e Çairit. "Na janë dorëzuar një numër i madh i projekteve për ndërtimin e shkollave. Nga Komuna e Çairit kemi projekte për shkollën e nxënësve me nevoja të veçan-

ta 'Idnina' dhe SHF 'Vasil Gllavinov' dhe padyshim se do të mirëpresim edhe kërkesa të tjera", pohon zëvendësministri Ademi, duke lënë të hapur mundësinë e investimeve nga ana e MASH-it edhe për shkollat të tjera, që për momentin nuk janë në Programin e investimeve kapitale të 2018-ës. Pavarësisht kësaj, Ganiu thotë se ekzistojnë mundësi që zgjerimi i shkollave "Ismail Qemali" dhe "Liria" të bëhen pjesë e atij programi posa të përfundojë kompletimi i dokumentacioneve përkatëse. "Meqë bëhet fjalë për zgjerime deri në 20 pind të hapësirave, ekziston mundësia që Komuna të nis procedurat për zgjerimin e këtyre dy shkollave. Ne jemi duke kompletuar dokumentacionin e nevojshëm të cilin do ta kemi gati shumë shpejt dhe të njëjtin do t'ia dërgojmë MASH-it", sqaron kryetari Ganiu, duke u shprehur optimist se në shtator, SHF "Ismail Qemali" dhe SHF "Liria" do të jenë më hapësira të zgjeruara. Sipas tij, edhe nëse punimet ndërtimore nisnin në muajin qershor, ka aq kohë sa të dyja këto shkolla ta presin shtatorin me hapësira të zgjeruara. Në të njëjtën kohë, sikurse pohon

VIJOJNË AKTIVITETET PËR VITIN E GJERGJIT

"Shkupi për Skënderbeun" një rrëfenje ndryshe

Libri është botuar në tre gjuhë, shqip-maqedonisht - anglisht dhe krahas kumtesave të mbajtura në shënimin e 550 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, më 17 janar në akademinë e mbajtur në Parlament janë përfshirë edhe tekste shkencore nga studiues të huaj, si edhe dokumente të pazbardhura më parë



Koha Evis HALILI

Shkup, 2 mars - Një prej datave më të rëndësishme të historisë së mesjetës - 2 Marsi, mbledhja e Kuvendit të Lezhës, është shënuar në Shkup me promovimin e një botimi të veçantë, të titulluar "Shkupi për vitin e Skënderbeut", nën kujdesin e Institutit të Trashëgimisë

Shpirtërore e Kulturore dhe si pjesë e manifestimeve mbarëshqiptare që po zhvillohen në kuadër të Vitit të Gjergjit. Libri është botuar në tre gjuhë, shqip-maqedonisht - anglisht dhe krahas kumtesave të mbajtura në shënimin e 550 vjetorit të vdekjes së Skënderbeut, më 17 janar në akademinë e mbajtur në Parlament janë përfshirë edhe tek-

ste shkencore nga studiues të huaj, si edhe dokumente të pazbardhura më parë. "Ky edicion është edhe një hallkë tjetër shkencore për studimin e jetës dhe bëmave të Gjergj Kastriotit. E veçanta e këtij botimi padyshim është se në të si rrallëkund tjetër janë përfshirë qasje shqiptare, maqedonase dhe të huaja, duke sjellë një Skënderbe

që deri tani pak kush e ka vërejtur. Është ky Skënderbeu që unifikon dhe nuk na përplas, është ky Skënderbeu që bashkon kombet dhe që jep mesazhin e bashkëjetesës. Zaten kjo nuk do të ishte e mundur askund, pos në Shkup, në çerdhen multietnike dhe multireligjioze të Ballkanit", u shpreh drejtori i IT-SHKSH, Skënder Asani. Në promo-

vimin e zhvilluar në ambientet e IT-SHKSH ishin të pranishëm edhe kreu i Parlamentit, Talat Xhaferri, zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi. Në fjalën e tij zëvendësministri ka inkurajuar institutin për të vazhduar me projekte të tilla që lidhen me figurën më të rëndësishme të historisë shqiptare dhe më përbashkuesen e të gjitha brezave. Duke analizuar figurën dhe kontributin shumëdimensional të heroit kombëtar, historiani Vllado Popovski thotë se vepra e Gjergj Kastriotit vite më vonë ka qenë frymëzim jo vetëm për shqiptarët, por edhe maqedonasit.

"Në frymën e veprës skënderbiane, e shprehur veçanërisht në planin e ndërtimit të përbashkësisë, të respektit ndaj dallimeve kulturore, barazi dhe mosdiskriminim, edhe lëvizja çlirimtare maqedonase nga fillimi i luftës së saj shtetformuese, projektoi dhe angazhohej për një shtet shumetnik..., si projekti i Ligës maqedonase, Republika e

kryetari i Komunës, punohet në planin e ndërtimit të shkollave të reja. "Për momentin jemi duke parë mundësinë e ndërtimit të një kopshti dhe një shkolle fillore në hapësirat që gjenden mes Universitetit Ndërkombëtar Ballkanik dhe lokacionit për ndërtimin e Universitetit 'Nënë Tereza'. Por, meqë bëhet fjalë për tokë e cila gjendet në kufijtë matanë Komunës së Karposhit, duhet që të dyja komunat, pra Çairi dhe Karposhi të merreni vesh se cili do të ishte varianti më i volitshëm për ndërtimin e asaj shkolle", thotë Ganiu. Në Planin detal Urbanistik të Komunës së Karposhit, në vendin e synuar është paraparë ndërtimi i një kopshti dhe shkolle fillore. Por, në këtë pjesë të komunës fqinje nuk ka aq banor sa të kenë nevoja për ndërtimin e kopshtit dhe shkollës, ndërkohë që në kufijtë e këtij Komunës së Çairit - nevoja kopshte dhe shkolle është jashtëzakonisht e madhe. Kadri Agushi, drejtori i SHF "Ismail Qemali" thotë se nevoja për sigurimin e klasave të reja është urgjente. "Për zgjidhje afatgjate, patjetër që duhet të ndërtohet një shkollë e re, pasi do të shkojë në rreth dy mijë numri i nxënësve. Objekti ekzistues mund të zgjerohet me tetë klasë të reja dhe kjo do të zbut dukshëm problemin hapësiror. Mirëpo do të kemi problemin e mbingarkesës. Imagjini një shkollë fillore me rreth dy mijë nxënës se si mund të funksionojë", shprehet drejtori. Në të njëjtën kohë, Agushi, e vlerëson si shumë pozitive edhe zgjerimin si zgjidhje afatshkurte. "Mentalisht kemi 49 paralele, mirëpo vitin e ardhshme ku numër do të shkojë në 50. Në shkollë kemi vetëm 20 klasë të rregullta për zhvillimin e mësim."

Për shkak të mungesës së hapësirave kemi improvizuar edhe 4-5 klasa, të cilat nuk do të na mjaftojnë që të organizojmë mësimin për vitin tjetër. Edhe tani nxënësit e klasave të para i vendosim në çerdhen përballë ku mësojnë në tre ndërrime. Pra gjendja është tepër alarmante", shprehet drejtori Agushi.

Krushevës..., ASNOM.. I tillë është edhe shembulli me MO në vitin 200, me të cilat Maqedonia arriti lidhshmërinë me të gjitha përvojat pozitive në këtë plan, përfshirë edhe atë që e përmban vepra e Skënderbeut", thotë historiani Popovski. Duke iu referuar poetit Gligor Përliçev dhe poemës së tij "Skënderbeu" historiani Dragi Gjeorgiev (drejtor i Institutit të Historisë Nacionale) shkruan se miti i Skënderbeut ka qenë i pranishëm në memorien e popullit maqedonas dhe ka ndikuar në lëvizjet e tij për liri. "Skënderbeu mbetet heroi më i madh i popullit shqiptar, por në të njëjtën kohë mbetet edhe njëri nga heronjtë më të mëdhenj që është paraqitur në skenën e Ballkanit dhe Mesdheut Lindor. Është një hero që mund të jetë urë që lidh disa kombe bashkëkohore ballkanike, para së gjithash kombin maqedonas dhe shqiptar. Ajo që mund të zbulohet në pluhurin e shtresuar të mesjetës mund të jetë udhërrëfyes në shekullin e ri", shkruan Gjeorgiev. Në libër përfshihen edhe tekste të tjera shkencore si Prezantimi i Skënderbeut para lexuesve anglezë në 1596 nga David Hosaflook, Zoja e Shkodrës dhe përhapja në Evropë pas vdekjes së Skënderbeut (nga Albert Ramaj dhe Zef Ahmeti), Qasje ndaj indiceve në dokumentet osmane në lidhje me Skënderbeun (osmanologu Ermal Nurja), e të tjera.

Sipas profesorit universitar, Neritan Turkeshi të gjitha masat e tanishme për rritjen e natalitetit apo tentimet e zbehta për të mbajtur fuqinë punëtore në Maqedoni nuk kanë arritur të krijojnë një perspektivë më të qartë të jetesës në vend, me qëllim popullata që e ka mendjen të ikë, së paku të mendojë të mbetet në vendlindje

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 2 mars - Maqedonia deri në vitin 2050 do të humb 4.4 për qind të popullatës. Kjo me fjalë të tjera nënkupton se në 32 vitet e ardhme do të humbet një qytet i tërë si Kumanova.

Ose popullata e Maqedonisë do të zvogëlohet nga 2 milion e 83 mijë në vitin 2017 në një milion e 991 mijë në vitin 2050.

Sipas parashikimeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, shteti më i goditur nga humbja e popullatës është Serbia që do të humb 33.2 për qind të popullatës apo një Beograd të tërë. Popullatë në Slloveni do të zvogëlohet për 23 për qind, ndërsa në Bullgari për 22 për qind. Shqipëria do të humb afër 3.6 për qind të popullatës apo nga 2 milionë e 930 mijë në 2 milionë e 825 mijë. Sipas projeksioneve të tërë rajoni do të ballafaqohet me zvogëlimin e numrit të popullatës, me përjashtim të Kosovës. Kosova do të shënojë rritje të popullatës prej 1.9 milion në 2 milionë e 223 mijë.

Sipas ekonomistëve, humbja kaq e madhe e popullatës tek ne shkaktohet si nga ulja e natalitetit, ashtu edhe nga shpërngulja e

ZVOGLIMI I POPULLSISË



madhe të popullatës që si procese do të ndikojnë negativisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Maqedonisë. Sipas profesorit universitar, Neritan Turkeshi të gjitha masat e tanishme për rritjen e natalitetit apo tentimet e zbehta për të mbajtur fuqinë punëtore në Maqedoni nuk kanë arritur të krijojnë një perspektivë më të qartë të jetesës në vend, me qëllim popullata që e ka mendjen të ikë, së paku të mendojë të mbetet në vendlindje.

"Aktualisht në rastin e Maqedonisë është shqetësuese se biletë në një drejtim marrin jo vetëm mjekët, inxhinierët e profileve të ndryshme, apo specialistët e informatikës, por edhe zanatlinjtë e profileve të ndryshme. Bile në kohë të fundit na ikin edhe profesorë universitetar në drejtim të shteteve arabe si trend i ri përkundër jetesës së shtrenjtë në këto shtete", thekson Turkeshi. Sipas tij anëtarësimi në strukturat euroatlantike do të zbusë pak këto trende negative të ikjes jashtë, por përmirësimi

më i madh i situatës brengosëse nuk do të ndodh brenda natës. Turkeshi shton më tej se ulja e natalitetit dhe ikja e popullatës jashtë shtetit është një problem i madh që shqetëson jo vetëm Maqedoninë, por të gjitha shtetet në rajon që përpiqen me rezultate të dobëta të luftojnë këto fenomene. "Është folur në të kaluarën dhe po flitet akoma për masat e ndryshme për zbutjen e këtyre problemeve, por megjithatë çështja e parë dhe kryesore për rritjen e natalitetit dhe uljen e trendit të mërgimit jashtë, është që njerëzit të shohin një perspektivë të qartë të jetojnë në Maqedoni, të investojnë këtu, si dhe të paramendojnë edhe jetesën e fëmijëve të tyre në këtë shtet. Kjo kërkon që shteti me të vërtetë të jetë shërbëtor i qytetarit në çdo aspekt si dhe funksionimin si duhet të sistemit arsimor, shëndetësor dhe gjyqësor për të cilin shpesh nuk nevojitet më shumë para apo punësime, por një menaxhim më i mirë i resurseve ekzistuese", thotë Turke-

shi. Element tjetër i rëndësishëm për zbutjen e ikjes së popullatës që shkatërron edhe themelet për një rritje më të madhe ekonomike, sipas Turkeshit, është edhe rritja e pagave së paku për dhjetë për qind, hapja e vendeve të reja të punës nga sektori privat, mbështetja më e madhe e sipërmarrjes dhe zanateve, ulja e papunësisë me vende pune me paga më të larta etj.

Ndryshe, edhe çështjet e shumta të pazgjidhura politike në rajon, mosndarja e qarta e pushteteve ndërmjet kuvendit, qeverisë dhe gjyqësorit, mungesa e vëmendjes më të madhe të qendrave perëndimore të vendosjes si dhe thënia e Çerçilit se "popujt e Ballkanit prodhojnë me shumë histori se sa që munden ta përballojnë", goja plot reforma e qeverive të rajonit që pak jetësohen në praktikë, renditen nga njohësit e rrethanave politike të rajonit si disa nga shkaqet pse Ballkani Perëndimor shumë ngadalë po stabilizohet në aspektin politik dhe ekonomik.

Sëmuret avokati, shtyhet seanca për Grujevskin dhe Boshkovskin

Athinë, 2 mars - Për të premtën e ardhshme, 9 mars, është shtyrë seanca gjyqësore në Gjykatën Supreme pas ankesës së parashtruar për ekstradimin e Goran Grujevskit dhe Nikolla Boshkovskit, Njëri prej dy avokatëve nga ekipi grek që i mbron dy ish-zbuluesit, mungonte për shkak të sëmundjes dhe prandaj kolegu i tij kërkoi shtyrje. Për dallim nga hera e kaluar, në seancën e parë gjyqësore në Gjykatën Supreme para dy javësh, tani pati përkthyes nga gjuha maqedonase në greke dhe anasjelltas. Në sallën gjyqësore në Gjykatën Supreme, siç raporton korrespondenti i MIA-s nga Athina edhe këtë herë të pranishëm ishin Nikolla Boshkovski dhe Goran Grujevski të cilët me shoqërim policor u sollën nga burgu i Athinës "Koridalos". Kryetarja



e Këshillit të gjykatësve, ju bëri thirrje dy ish-zbuluesve për të cilët kërkohet ekstradimi në Maqedoni, iu sqaroi se njëri nga avokatët është i sëmurë dhe kërkoi qëndrim edhe prej tyre, nëse pajtohen që seanca të shtyhet, që të mund edhe ai të jetë i pranishëm. "Është shumë

me rëndësi për ne dhe për rastin sepse është me ne që nga fillimi dhe e njeh çështjen", tha Grujevski.

Ndërsa në pyetjen nëse pajtohen që seanca të shtyhet, që të dy u përgjigjën me konfirmim. Pasi Këshilli prej gjashtë anëtarëve të gjykatësve dhe

prokurorëve, kompetentë për shqyrtimin e ankesës në Gjykatën Supreme greke, e dëgjuan elaborimin e avokatit dhe qëndrimin e Grujevskit dhe Boshkovskit, vendosën që seanca të shtyhet për të premtën e ardhshme. Megjithatë, siç lajmëroi korrespondenti i MIA-s nga Athina, gjykatësja kryesuese, potencoi se kjo do të jetë shtyrja e fundit. Ankesa në Gjykatën Supreme në Athinë për ekstradimin e Grujevskit dhe Boshkovskit, u shqyrtua me edhe 20 raste të tjera. Nga Gjykata Supreme në qendrën e Athinës, ish-shefi i DSK-së Goran Grujevski dhe kolegu i tij Nikolla Boshkovski, sërisht u kthyen në burgun e Athinës "Koridalos", ku u vendosën nga 13 shkurti pas transferimit të tyre nga Selaniku në Athinë.

Në bazë të nenit 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16), nenit 22, ndërsa në lidhje me nenin 14 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 74/15, 167/15 dhe 27/16) dhe nenit 143 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16 dhe 163/17), dhe pëiqim me shkrim nr. 18-2383/2 dhe 18-2384/2 të 22.02.2018, të parashtruar nga ministria e financave të RM, si dhe Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Detelinka" – Kriva Pallankë nr. 0101-145/2 nga 07.09.2015, Metodologjisë për planifikim të të punësuarve në sektorin publik, Planin vjetor për punësim me nr. ark. 03-76/9 të datës 14.11.2017. Drejtoresha e Institucionit publik komunal për fëmijë – Çerdhja për fëmijë "Detelinka" Kriva Pallankë publikon

SHPALLJE
Për punësim për kohë të pacaktuar]

Institucioni publik komunal për fëmijë – Çerdhja për fëmijë "Detelinka" Kriva Pallankë ka nevojë për punësim të:

1. Defektolog – një (1) realizues
2. Edukator – një (1) realizues
3. Përkëdhelës - dy (2) realizues
4. Punëtor të kottave të ngrohjes - një (1) realizues
5. Mirëmbajtës të higjienës - një (1) realizues

1. Përpos kushtet e përgjithshme të përcaktuara me nenin 142 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve, kandidati me numër rendor 1 duhet të përmbushë edhe kushtet e nevojshme për vendin e punës **Defektolog** edhe atë

- Të fituar 240 kredi sipas ECTS apo të mbaruar arsim të lartë shkalla VIII/IFakulteti filozofik – Arsimimi (defektolog)
- Licencë të vlefshme për punëtorë profesional
- Me ose pa përvojë pune

- Orari i ditor i punës: 8 orë (prej orës 7:30 – 15:30)

- Orari javor i punës: 40 orë (prej të hënës deri të premten)
- Neto paga themelore: 20.056, 00 den.

Përpos kushtet e përgjithshme të përcaktuara me nenin 142 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve, kandidati me numër rendor 2 duhet të përmbushë edhe kushtet e nevojshme për vendin e punës **Edukator** edhe atë: të ketë përgatitje të mbaruar sipërore profesional – profesor i diplomuar për edukim parashkollor, edukator i diplomuar të fëmijëve për moshë parashkollore dhe pedagog i diplomuar për edukim parashkollor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose arsim të mbaruar sipëror shkalla VIII/1

- Me ose pa përvojë pune,
- Licencë valide për edukator,
- Neto pagesa bazë në shumë prej 19.581,00 denarë për arsim sipëror,
- 40 orë pune në javë, në ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte
- Orari i punës prej ora 07:00 deri në ora 13:00.

2. Përpos kushtet e përgjithshme të përcaktuara me nenin 142 nga Ligji për mbrojtje të fëmijëve, kandidati me numër rendor 2 duhet të përmbushë edhe kushtet e nevojshme për vendin e punës **Përkëdhelës**, edhe atë: të ketë të mbaruar arsim të mesëm katërveçar:

- Me ose pa përvojë pune,
- Licencë valide për përkëdhelës,
- Neto pagesa bazë në shumë prej 14.780,00 denarë,
- 40 orë pune në javë, në ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte,
- Orari i punës prej ora 06:30-14:30, 07:30-15:30, 08:30-16:30.

Përveç fletëparaqitjes, kandidatët me numër rendor 1 (defektolog), nr. 2 (edukator) dhe nr. 3 (Përkëdhelës) duhet të parashtrorj edhe dokumentet në vijim:

- Diplomë për arsim të mbaruar sipëror për defektolog dhe edukator dhe dëftesat prë arsim të mbaruar katërveçar për përkëdhelës,
- certifikatë shtetësisë së Republikës së Maqedonisë,
- certifikatë të lindjes,
- vërtetim që nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës,
- vërtetim që nuk i shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën dënohet për veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur ose abuzim farefinisor, për veprë penale të grupit të veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese dhe

3. Përpos kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidatët me nr. rendor 3 duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme për vendin e punës **Punëtor të kottave të ngrohjes** edhe atë: të kenë të mbaruar arsimin e mesëm III ose IV vjeçar:

- Me ose pa përvojë pune
- Neto pagesa bazë në shumë prej 12.415,00 denarë,
- 40 orë pune në javë, në ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte dhe
- Orari i punës prej ora 05:00 deri në ora 13:00.

4. Përpos kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidatët me nr. rendor 3 duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme për vendin e punës **Mirëmbajtës të higjienës**, edhe atë: të kenë të mbaruar arsimin fillor ose të mesëm:

- Me ose pa përvojë pune,
- Neto pagesa bazë në shumë prej 12.006,00 denarë,
- 40 orë pune në javë, në ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte dhe orar të punës me orar ditor prej ora 08:00 deri në ora 16:00,
- 5. Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët përveç fletëparaqitjes, kandidatët me numër rendor 3 – Punëtor i kottave të ngrohjes, nr. 4 – Mirëmbajtës të higjienës, duhet të parashtrorj edhe dokumentet në vijim:
- Dëftesat për arsim të mbaruar (për vendin e punës me nr. rendor 3 – arsim të mesëm III ose IV vjeçar, ndërsa për të tjerët arsim fillor ose të mesëm),
- Certifikatë shtetësisë së Republikës së Maqedonisë dhe
- Certifikatë të lindjes.

Shpallja do të **zjosë 5 (pesë) ditë pune** nga dita e publikimit në gazetat ditore, duke mos konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 (peshëmbëdhjetë) ditë pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme (dokumente – origjinal ose kopje të vërtetuar në noter) të parashtrohen në zarf të mbyllur pa ndonjë shenjë në Drejtorinë e IPKÇF "Detelinka" Kriva Pallankë, ose përmes postës në adresën në vijim në rr. "Sv. Joakim Osogovski" nr. 51

1330 Kriva Pallankë me shenjë të vetme

"Për shpallje publike për punësim për kohë të pacaktuar"

Dokumentet jo të plota, të pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Kontakt telefoni 031/375-527.

IPKÇF "DETELINKA"
Kriva Pallankë

Në bazë të nenit 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Lajmërimin nga Ministria e financave nr. 18-1997/2 të 15.02.2018 dhe Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 0401-125/1 të 01.03.2018, IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar

1. IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup ka nevojë për punësim të:
1 (një) doktor të medicinës në specializim për anesteziologji dhe mjekim intensiv;

2. Kandidatët duhet të përmbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore

- të jetë shtetas i RM;
- të jetë i moshës së rritur;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

3. Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim:

- arsim të mbaruar sipëror me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i medicinës
- provim të dhënë profesional
- licencë për punë
- njohje të 1 (një) prej gjuhëve të huaja
- të ketë Vendim për specializim të miratuar për anesteziologji dhe mjekim intensiv

4. Orari i punës është 40 orë në javë dhe neto pagesa fillestare prej 29.700,00 denarë.

5. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar të parashtrorj dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt (adresë, telefon celular, e-mail)
- biografi të shkurtë (CV)
- diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar sipëror me sukses mesatar, në original ose kopje të vërtetuar në noter
- Dëshmi për njohje të një prej gjuhëve botërore (angleze, gjermane ose frënge)
- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, në original ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në original ose kopje të vërtetuar në noter
- certifikatë për provim të dhënë profesional, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- vendim për specializim të miratuar për anesteziologji dhe mjekim intensiv, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- licencë për punë, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike me dokumentacion të kompletuar është deri më 12.03.2018.

7. Përparësi gjatë zgjedhjes do të kenë kandidatët të cilët në një periudhë më të gjatë kanë qenë të angazhuar në IPSH KU për kardiokirurgji shtetërore.

8. Dokumentacioni i vonuar, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

9. Fletëparaqitja me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt të parashtrohen, deri në IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup rr. Nëna Terezë nr. 17/8, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup, ndërsa me shenjë për Shpallje publike për punësim nr. 0401-125/2.

Telefoni për kontakt: 02 3 113 053

IPSH Klinika universitare
për kardiokirurgji shtetërore – Shkup

Në bazë të nenit 38 dhe 43 të Ligjit për veprimtari hulumtuuese shkencore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 27/2014, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16), IPSH Instituti i Historisë Nationale shpall

KONKURS PUBLIK
PËR ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME NË TITULL SHKENCOR NË IPSH INSTITUTI I HISTORISË NACIONALE

-2. këshilltar shkencor/profesor i rregullt në Njësinë për histori antike dhe mesjetare të Maqedonisë (deri në vitin 1371),

-1 bashkëpunëtorë të lartë shkencor/profesor jo i rregullt në Njësinë për histori antike dhe mesjetare të Maqedonisë (deri në vitin 1371)

Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e: Ligjit për veprimtari hulumtuuese shkencore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 46/2008, 103/2008, 24/2011, 80/2012, 24/2013, 27/2014, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 53/16), Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" 35/2008, 103/2008, 26/2009, 99/2009, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013 dhe 24/2013), Rregullores për mënyrën e zgjedhjes në titullin me të lartë ("Gazeta zyrtare" 82/2009) si dhe të Rregullores për kriteret dhe mënyrën e zgjedhjes në titujt arsimoro-shkencor, shkencor, bashkëpunëtorë të lartë të Universitetit "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 173/2011).

Kandidatët duhet të dorëzojnë:

- fletëparaqitje
- biografi (në formë të shtypur dhe elektronike)
- bibliografi (në formë të shtypur dhe elektronike)
- diplomë apo vërtetim të marrjes së titullit doktor shkencor (dokument origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- kopje të çdo punimi shkencor

Dokumentet dorëzohen në Institutin e Historisë Nationale rr. Gligor Përliçev nr. 3 Shkup (tel. 3115-831) në afat prej 8 ditësh nga dita e shpalljes së konkursit.

INSTITUTI I HISTORISË NACIONALE

I nr. 1958/2016

SHPALLJE PUBLIKE

Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përmbaresei **Aleksandar Kuzmanovski** nga **Gostivari** në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori Halk Bank SHA Shkup nga Shkupi me sell në rr. "Sv. Kiril i Metod" nr. 54, bazuar në dokumentin për përbarim Akti noterial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Noterit Përparim Rexhepi, Gostivar, kundër borxhitut Ardijan Ramadani nga Gostivari me sell në f. Bellovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadani nga Gostivari me sell në f. Bellovishtë, për realizim të përbarimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përmbareuse të regjistruar nën I nr. 1958/2016 të datës 28.02.2018:

FTON

1. Borxhliut Ardijan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me sell në f. Bellovishtë, për shkak të dorëzimit të:

- Konkuzionit për shtyrje të përbarimit në bazë të nenit 81 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 18.01.2018 të Përmbareusit **Aleksandar Kuzmanovski** nga Gostivari
- Konkluzion për Shtjten e dytë publike me gojë në bazë të nenit 167 paragrafi 1, nenit 169 paragrafi 1, nenit 170 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.02.2018 të Përmbareusit **Aleksandar Kuzmanovski** nga Gostivari.
- 2. Personin Zhivka Anjevaska nga Shkupi me banim në bul. Ilinden 9-4 për shkak të dorëzimit të:
- Konkuzionit për shtyrje të përbarimit në bazë të nenit 81 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 18.01.2018.
- Lajmërim nga 20.02.2018,
- Konkuzion për Shtjten e dytë publike me gojë në bazë të nenit 167 paragrafi 1, nenit 169 paragrafi 1, nenit 170 paragrafi 1 të LP I nr. 1958/2016 të datës 19.02.2018 të Përmbareusit **Aleksandar Kuzmanovski** nga Gostivari.

Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.

PARALAJMËROHEN borxhliu **Ardijan Ramadani**, debitori i pengut **Qemal Ramadani** dhe personi **Zhivka Anjevaska** se mënyra e këllitë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala.

Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E TRETË.

Përmbareus
Aleksandar Kuzmanovski

Shitet tokë në Shkup, gjendet në Çajlanë;

PK 580/1 vendi i quajtur Rapshec, me sipërfaqe prej 868m2, e regjistruar ne Flet pronësi nr. 268 për KK Çajlanë pronësi e Sherefedin Skenderi.

Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelat në fjalë, ofertat e tyre mund t'i paraqesin në zyrën e Noterit Mahir Ziberit, rr.

Butelska nr. 4, Shkup-Butel.

Në bazë të nenit 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Lajmërimin nga Ministria e financave nr. 18-1997/2 të 15.02.2018 dhe Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 0401-126/1 të 01.03.2018, IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar

1. IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup ka nevojë për punësim të:

- 1.1 18 (tetëmbëdhjetë) Motra medicinale me arsim të mesëm të medicinës;
- 1.2 1 (një) Teknolog të radiologjisë – Punëtor i shëndetësisë me arsim sipëror;
- 1.3 1 (një) Fizioterapeut – Punëtor i shëndetësisë me arsim sipëror;

2. Kandidatët duhet të përmbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore

- të jetë shtetas i RM;
- të jetë i moshës së rritur;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës
- 3. Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim:

Për kandidatin nën pikën 1.1

- arsim të mesëm të mbaruar të medicinës (shkalla IV-1),
- provim të dhënë profesional,
- me ose pa përvojë pune,

Për kandidatin nën pikën 1.2

- Me cikël të parë të mbaruar të arsimit sipëror me titull Teknolog i radiologjisë (min. 180 kredi sips SETK ose niveli VI-b),
- provim të dhënë profesional,
- me ose pa përvojë pune,

Për kandidatin nën pikën 1.3

- Me cikël të parë të mbaruar të arsimit sipëror me titull Fizioterapeut (min. 180 kredi sips SETK ose niveli VI-b),
- provim të dhënë profesional,
- me ose pa përvojë pune,

4. Orari i punës është 40 orë në javë dhe neto pagesa fillestare:

- Për kandidatin nën pikën 1.1 është 18.400,00 denarë.
- Për kandidatin nën pikën 1.2 është 22.500,00 denarë.
- Për kandidatin nën pikën 1.3 është 22.500,00 denarë.

5. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët janë të obliguar të parashtrorj dokumentet në vijim:

Për kandidatin nën pikën 1.1

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt (adresë, telefon celular, e-mail)
- biografi të shkurtë (CV)
- dëshmi për arsim të mesëm të mbaruar të medicinës (SHMM) për motër medicinale dhe atë dëftesat e të gjitha 4 (katër) viteve ku është theksuar suksesi që është arritur në SHMM për secilin vit veç e veç (në original ose kopje të vërtetuar në noter)
- Dëshmi për provim të dhënë profesional (në original ose kopje të vërtetuar në noter)
- certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (në original ose kopje të vërtetuar në noter)
- certifikatë të shtetësisë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (në original ose kopje të vërtetuar në noter)

Për kandidatin nën pikën 1.2 dhe 1.3

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt (adresë, telefon celular, e-mail)
- biografi të shkurtë (CV)
- Dëshmi për arsim të mbaruar – Diplomë ose certifikatë për cikël të parë të mbaruar të studimeve min. 180 kredi ose VI-b, me sukses mesatar, edhe atë për pikën 1.2 – Teknolog i radiologjisë dhe për pikën 1.3 – Fizioterapeut (në original ose kopje të vërtetuar në noter), ku theksohet suksesi që është arritur në studimet e mbaruara.
- Dëshmi për provim të dhënë profesional (në original ose kopje të vërtetuar në noter)
- certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore, jo më të vjetër se 6 muaj (në original ose kopje të vërtetuar në noter)
- certifikatë të shtetësisë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter),
- certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, jo më të vjetër se 6 muaj (në original ose kopje të vërtetuar në noter)

6. Afati për paraqitje në shpalljen publike me dokumentacion të kompletuar është deri më 12.03.2018.

7. Përparësi gjatë zgjedhjes do të kenë kandidatët të cilët në një periudhë më të gjatë kanë qenë të angazhuar në IPSH KU për kardiokirurgji shtetërore.

8. Dokumentacioni i vonuar, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.

9. Fletëparaqitja me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt të parashtrohen, deri në IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup rr. Nëna Terezë nr. 17/8, përmes postës ose në arkivin e IPSH Klinika universitare për kardiokirurgji shtetërore – Shkup, ndërsa me shenjë për Shpallje publike për punësim nr. 0401-126/2 dhe shenjë se për cilën pikë (vend të punës) parashtrohet fletëparaqitja.

Telefoni për kontakt: 02 3 113 053

IPSH Klinika universitare
për kardiokirurgji shtetërore – Shkup

PARALAJMËROHEN UZURPATORËT

AKSION PËR PASTRIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE

Situata me uzurpimin e trotuareve vazhdon të jetë problem permanent në rrugët e Tetovës. Kësisoj, trotuare dhe rrugë të pakalueshme, vetura të parkuara gjithandej, ngarkim-shkarkim i mallit pa respektuar orarin prej orës 19 në mbrëmje deri ora 7 në mëngjes, janë pjesë e kaosit në këtë qytet

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 2 mars - Komuna e Tetovës, Sektori për Punë të Brendshme -Tetovë dhe Inspektorati shtetëror i tregut, ditëve në vazhdim do të fillojnë aksion të koordinuar për lirimin e hapësirave publike, trotuareve dhe sipërfaqeve të gjelbëtra. "Njoftojmë se në pajtim me nenin 5, paragrafi 4, nga Ligji për Pastërti Publike, duhet që ta lironi hapësirën publike përpara lokalit tuaj afarist, i cili duhet të jetë në shërbim publik i dedikuar për të gjithë këmbësorët dhe qytetarët e Tetovës. Pastrimi dhe lirimi i hapësirës publike dhe trotuareve bëhet me qëllim që të mundësohet qarkullimi i lirshëm i këmbësorëve, të mundësohen shtigje të sigurt qarkullimi për nxënësit, fëmijët dhe nënat me fëmijë, të mundësohet lirimi i hapësirave të gjelbërta dhe të njëjtat të vendosen në

funksion të shfrytëzimit të lirë nga të gjithë qytetarët e Tetovës", thonë nga komuna e Tetovës. Pronarët e këtyre hapësirave të uzurpuara paralajmërohen se nëse nuk ndërmarrin masa për largimin e të njëjtave, atëherë këtë do ta bëjnë institucionet përgjegjëse. "Lirimin e hapësirës publike, trotuareve dhe hapësirave të gjelbëra duhet patjetër ta bëni në afat prej 8 ditësh nga pranimi i këtij njoftimi. Në të kundërtën, shërbimet e Inspektoratit Komunal, i Ministrisë për Punë të Brendshme dhe Inspektorati shtetëror i tregut, do të inicojnë procedurë për largimin e tyre, në përputhje me predispozitat ligjore në fuqi", paralajmërojnë nga Komuna e Tetovës. Nga ana tjetër, situata me uzurpimin e trotuareve vazhdon të jetë problem permanent në rrugët e Tetovës. Kësisoj, trotuare dhe rrugë të pakalueshme, vetura të parkuara gjithandej, ngarkim-shkarkim i mallit pa respektuar orarin prej orës 19 në mbrëmje deri ora 7 në mëngjes janë pjesë e kaosit në këtë qytet. Mallrat nëpër markete të ndryshme zbarkohen edhe në mes të ditës, ndërsa transportuesit e bllokojnë rrugën dhe më pas krijohet tollovia në rrugët e Tetovës edhe pse ekziston një vendim i sjellë nga përbërja e kulluar e Këshillit të Tetovës që ngarkim-shkarkimi i mallit në disa rrugë të qytetit të bëhet me orar të caktuar. Këtë vendim nuk e respektojnë as marketet në rrugën Industriale në Tetovë, e cila më herët njihet si më e lehtë për qarkullim dhe nuk krijohej tollovi, por tash edhe në këtë rrugë, gjysma e saj që të çon për në dalje të Tetovës për në Gostivar, është uzurpuar nga kamionët të cilët shkarkojnë mallin në mes të ditës. Nga Komuna e Tetovës theksojnë se në bashkëpunim me policinë në

këtë sferë do të ketë më shumë kontrolle që të vendoset një rend dhe standard se kur duhet që malli të ngarkohet apo shkarkohet. "Ka një vendim të Këshillit se kur duhet që të bëhet ngarkim-shkarkimi i mallit. Është e evidente se ky vendim nuk respektohet dhe prandaj shumë shpejt - nëpër këto rrugë do të vendosen shenja njoftuese ku do të jetë i shënuar orari se kur pronarët mund të sjellin mallin nëpër marketet e tyre. Në të kundërtën, në bashkëpunim me policinë - do të ketë edhe sanksione adekuate. Po ashtu, në bazë të vendimit të Këshillit, nëse një pronar kërkon leje të posaçme, Inspektorati do të shqyrtojë kërkesën dhe më pas do të vendos se a do të jap leje që të ngarkojë apo shkarkojë mallin në orarin e kërkuar, gjithmonë nëse është e arsyeshme", thonë nga shërbimi për informim në Komunën e Tetovës. Dukuria e uzurpimit të hapësirave publike në Tetovë është problem që vite me radhë është aktual dhe assesi të gjejë zgjidhje. Malli në këtë pjesë të qytetit të Tetovës shkarkohet kur ju konvencionon atyre edhe pse në letër ka një vendim se kur duhet të bëhet ngarkim-shkarkimi. Kësaj situatë i kontribuon edhe mospasja e një institucioni të vetëm që do të merret me këtë problematikë. Qytetarët nga ana e tyre ankohen se në shumë raste duhet të zbrasin në rrugë, pasi trotuaret janë të zënë nga automjetet e ndryshme. Më vështirë janë rrugët që çojnë për dalje nga qyteti, ku janë edhe të vendosura shumica e marketeve. Edhe rruga nga qendra e Tetovës për tek stadiumi i qytetit çdo ditë është e stërngarkuar me automjete të cilët shkarkojnë mall nëpër markete dhe kjo mjafton që kjo rrugë të jetë e bllokuar dhe e vështirë për qarkullim.

Nëntë aksidente në Shkup, një person më rëndë i lënduar

Shkup, 2 mars - Një person është lënduar më rëndë në një nga gjithsej 10 aksidentet e trafikut që kanë ndodhur gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në dy aksidente më lehtë janë lënduar dy persona, ndërsa në shtatë aksidente është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të kundër-

vajtjeve. Njëzetë e tre shoferë kanë lëndur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, katër shoferë kanë kaluar në të kuqe në semafor, një shofer nuk iu ka dhënë përparësi kalimit të këmbësorëve, shtatë shoferë për reshtim të parregullt, një shofer për parakalim të parregullt dhe 12 shoferë të cilët nuk kanë poseduar pajisje dimërore. Nga qarkullimi janë përjashtuar nëntë shoferë

para se të pajisen me të drejtën për drejtim të automjetit, dy shoferë fillestarë, tre automjete teknikisht të parregullta dhe shtatë automjete pa regjistrim. Është sanksionuar edhe një këmbësor i cili ka kaluar jashtë vijave të shënuara për ta, ndërsa janë gjetur 90 vetura të parkuara në mënyrë joligjore. Me ndihmën e automjetit special të karrotrecit janë hequr 72 vetura.

KRONIKË

Vjedhje në Gostivar

28 vjeçari Z.G nga Gostivari, të enjten ka denoncuar vjedhje të rëndë në një objekt në ndërtim sipër të shoqatës aksionare Pellagonia, të locuar në rrugën "Major Çede Filipovski", në Gostivar, e cila është kryer në periudhën ndërmjet 23 shkurtit dhe 1 marsit. Sipas policisë, persona të panjohur kanë nxjerrë disa tjegulla dhe nga kati përdhës kanë bërë një vrimë prej nga kanë hyrë brenda dhe kanë marrë 350 metër katrorë rrjetë për fasadë. Me këtë vjedhje, ata kanë shkaktuar një dëm prej 7200 denarëve. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

20-vjeçares i keqpërdoret Instagrami

20-vjeçarja J.A nga fshati Bogovinë ka denoncuar keqpërdorim të të dhënave në Instagram. Sipas policisë, një person i panjohur në këtë rrjet social ka publikuar të dhënat e saja, informata dhe video të cilët kanë të bëjnë me jetën e saj private dhe i ka prishur imazhin e saj dhe të familjes. Punohet në zbardhjen e plotë të rastit. Keqpërdorim i Instagramit të saj ka ndodhur në një periudhë prej tre muajve.

Pengohet kontrabandë me emigrantë

Nëpunës policorë penguan tentim për kontrabandim të emigrantëve të cilët kanë qenë në një automobil në rrugën nga Kumanova drejt fshatit Kosturnik. Siç kumtoi MPB-ja, më 28 shkurt të vitit 2018, rreth orës 22:00 në rrugën nga Kumanova drejt fshatit Kosturnik, nga ana e policëve është vërejtur automobil "Mercedes" me targa të Kumanovës, i drejtuar nga B.I (38), ndërsa si bashkudhëtar ishte K.I (21) të dy nga Kumanova, nga i cili kanë dalë dy persona të panjohur. Nga ana e policëve është kryer legjitimim dhe bisedë, me ç'rast dy personat të moshës 38 dhe 48 vjeçarë nga Libia, deklaruan se kanë dashur të shkojnë deri në fshatin Llojan. Personat janë privuar nga liria, ndërsa nga ana e QR Veri deri te PTHP adekuate, kundër B.I. dhe K.I. janë ngritur kallëzime penale në bazë të nenit 418 b (kontrabandim të emigrantëve) nga LP i RM-së.

Tetovarja kafshohet nga qentë endacak në Kodrën e Diellit

24 vjeçarja A.A të enjten ka denoncuar se më 27 shkurt është sulmuar nga qen endacak në Kodrën e Diellit dhe ka pësuar lëndime në këmbën e djathtë. Pas një kohe, ajo është drejtuar për mjekim në Spitalin Klinik të Tetovës, e cila më pas ka dorëzuar dokumentacion komplet për llojin dhe karakterin e lëndimeve, me ç'rast nga ana e Stacionit Policor në Kodrën e Diellit i është dhënë udhëzimi se si të veprojë më tutje. (U.H)

Parimi i harresës!

Nga
Daut DAUTI



Jeta është dinamike që na shtyn që edhe gjërat që i kemi përjetuar si katarzë, t'i harrojmë shpejtë. Ku ishim dje, e ku jemi sot. Vetëm para një viti e ca, shteti përpëlitej në një krizë të thellë në përpjekje për ta detronizuar një pushtet të cilit i dolën këmbët përjashta. Një pushtet që u kap "me kërpesh" për dore, i cili në çdo vend demokratik do të kishte rënë kaheerë me skandalin e parë, e jo më dhjetëra skandale korruptive e keqpërdorime të cilat e zhveshën nga PR-imazhi i ndërnuar i ndershmërisë dhe drejtësisë. Vetëm falë strategjisë kokëfortë, ai pushtet vazhdoi agoninë e vet, në përpjekje për të shpëtuar diçka me parimin e simetrisë së fajit (edhe ju keni bërë njësoj), për të zbuluar ndonjë gjurmë gjersa të mos aktivizoheshin lëndët për ndjekje penale, si dhe, për të relativizuar fajësinë në sytë e qytetarëve.

Por, gjërat morën fund ashtu siç e dimë. Në pushtet më nuk janë Ata, po Këta, gjegjësisht, një pushtet tjetër me premtime të mëdha, me betime kategorike (Assesi si Ata më parë)... Nëse zgjedhjet e parakohshme parlamentare ende i nxorën fitues Ata (por me shenja të dukshme të rënies), në zgjedhjet lokale rënia ishte përfundimtare: VMRO-DPMNE-ja mbeti me numër komunash që numëroheshin me gishtat e një dore, porse edhe BDI-ja nuk kaloi pa "fasha" (vragë), duke e identifikuar edhe atë si bashkëpjesëmarrëse në mëkatet e partisë së Nikolla Gruevskit. Fati politik e deshi që të ndërrohen bashkudhëtarët në një rrugëtim të ri qeverisjeje, me parime të reja të deklaruara.

"Mos e bën atë për të cilën deri dje i ke kritikuar të tjerët... Mos i kritiko të tjerët për atë që e ke bërë vetë dikur!" Nëse kjo moto do të ishte një udhërrëfyes për çdo pushtet të ri, gjërat gjithnjë do të ecnin përpara, gjendja do të ndryshonte për më të mirë. Por, midis këtij parimi dhe praktikës, mund të gjendet një hendek i madh, jo vetëm për shkak të të paaftësisë për të bërë gjithnjë me mirë seç ka bërë ndonjë garniturë më parë, por dhe nga dobësitë e "materialit" njerëzor, të cilat nuk va-

ren nga ideologjitë dhe nga platformat e deklaruara në zgjedhje, por nga "sfidat" që jep pushteti si provokim "për ta shfrytëzuar momentin" që "nuk jepet më". Nuk ka nevojë "të përkthehet" ç'dua të them me këtë.

Unë e kam shkruar shumë herë se kjo qeveri jep shumë shpresa për të bërë ndryshime. Me hapat që i ka ndërmarrë në shtensionimin e marrëdhënieve me fqinjët, gatishmërinë dhe guximin për ta avancuar përdorimin e gjuhës shqipe me ligjin që e pengoi dhe e ktheu në procedurë kryetari Gjorge Ivanov, si dhe me gatishmërinë, jo vetëm deklarative, për të tejkaluar kontestin me Greqinë për emrin, me kthimin në rigjykim të rastit "Monstra", përpjekjet për reforma në gjyqësi... Por ka dhe gjëra që mund të merren si punë kot (si psh. paralajmërimi për shitjen e "Mercedesit" të famshëm të Gruevskit (si do ta shesin, është blerë 600 mijë dhe do ta shesin për 200 mijë euro?!), ose preokupimi me "Shkupin 2014" (si bie fjala heqja e "anijeve")... që në sytë e qytetarëve do të vërtetohet teza e VMRO-së se ata "kanë ndërnuar, ndërsa LSDM-ja rrenon"... Sido që të jetë, preokupimi dhe shpenzimi i energjisë së pushtetit të ri, pas gatise një viti qeverisjeje, me bëmat e qeverisë së kaluar, mund të jetë kapital politik për të arsyetuar politikën e saja të reja, porse dhe mund të jetë alibi për mosrealizimin e shumë premtimeve "për jetë" të cilat përfshinë shumë sfera, kurse mungesa e ideve për t'i përmirësuar gjërat, vjen duke u shtuar çdo ditë e më tepër!

Dehja e fitores mund të jetë jetëshkurtër, sepse më lehtë është që të fitosh (ndonëse në rastin e LSDM-së së Zaevit nuk qe aq lehtë), dhe më vështirë është ta mbash pushtetin. Pra, ta mbash ashtu siç e ke premtuar se do ta praktikosh atë. Nëse më lartë u dhanë disa shembuj, dhe u shprehën disa dilema, hyrja në temë me sprovat e vërteta të pushtetit të ri, mund të jenë edhe më dëshpëruese. Kur një aktor shqiptar komentoi se si janë ndarë paratë për film dhe bëri krahasimin midis një autori anonim maqedonas, të cilit i janë ndarë

disafish më shumë mjete për një film dokumentar se sa një autori shqiptar për film artistik, plus përqindjen e vogël për autorët shqiptarë, kjo ishte një sinjal që drejtësia për të cilën është angazhuar LSDM-ja në fushatë, është larg të deklaruarës, sepse egoizmi dhe proteksionizmi në baza të ndryshme (ndonëse më lehtë e vërejmë kur është në baza etnike), nuk çrrënjosen vetëm me fjalë, nëse nuk shoqërohen në veprë. Hapi tjetër që po ashtu u bë nga buxheti i kulturës, te ndarja e mjeteve për veprimtari botuese, dëshmoi një keqpërdorim që diskriminimin e bëri edhe intraetnik (të pakënaqur edhe botuesit maqedonas, edhe botuesit shqiptarë), por me përmasa ashiqare keqpërdorimi, duke e detyruar ministrinë për të bërë "revizion". Si do të përfundojë ky episod i pakëndshëm, ku erdhi në shprehje keqmenaxhimi me mjetet e taksapaguesve, është çështje tjetër, por që është sinjal brengosës për vetë kryeministrin Zaev. Sepse kështu mund të vepohet edhe në resorët tjerë të pushtetit, në ministri, drejtori, spitale, shkolla, agjenci, komisione..., në të cilat me vonesë mund të zbulohen abuzimet, por kur të zbulohen, mund ta sjellin këtë qeveri atje ku para dy vitesh ishte ajo e Gruevskit. Siç shihet, as mediat të cilat e përkrahnin ish-opozitën nuk e përhëndetin me ngazëllim propagandistik çdo politikë të qeverisë, e as qytetarët kanë dhënë blanko përkrahje pavarësisht se çka realizon dhe si vepron.

Të premtosh e të mos realizosh, është një shkurt-pamësi politike për fushatë zgjedhore, sepse mund të përfitosh në një çast të caktuar, por ajo "kredi" shpenzohet shumë shpejt, ose kthehet si bumerang. Shumëkush u josh nga heqja e taksës për radiotelevizion, por masa tjetër që atë taksë të zëvendësohet me 3 denarë që do të paguajnë ata që ngasin vetura dizel për çdo litër, të premtosh rritje pagash e pensionesh, heqje participimi për shërbimet

shëndetësore dhe ende të mos e bësh, të premtosh vende të reja pune, e nuk mund të sigurosh rritje zhvillimore as 1 për qind, të premtosh ligje më të favorshme për subjektet e ekonomike e nuk ke ide si ta bësh, ose zgjidhjet që ofrojnë çojnë ekonominë teposhtë (ka mjaft ankesa për mungesë idesh nga biznesi!), të premtosh se do të qeverisësh me nder dhe qeveris siç kanë qeverisur ata para teje, ... duhet të jetë çështje momenti kur do të harxhohen të gjitha kreditë parazgjedhore me ndonjë "bombë" që do t'ia kthejë opozita e tashme.

Për vete përherë kam qenë "i fascinuar" me noshalancën që partitë hyjnë në zgjedhje, kur premtojnë sipas asaj popullores "gjithçka që fluturon hahet", por në të vërtetë, në jetë është se "nuk hahet gjithçka që fluturon". Duhet përhëndetur çdo lëvizje që bëhet në drejtim të realizimit të premtimeve, por siç e shohim nuk është kollaj t'u qëndrosh mbrapa. Ka gjëra që do të mirëkuptohen, sepse në rrethana objektive, sado që të përpiqesh, ndonjë gjë edhe mund të dështojë. Por, nëse kjo qeveri harron se pse erdhi në pushtet, ose më saktë, se pse iku pushteti i Gruevskit dhe i përsërit të njëjtat dobësi ose anomalitë (korruption, keqpërdorim pushteti...), atëherë gjërat vetëm mund të përsëriten dhe të jenë shkak për dëshpërim të qytetarëve, të cilët as më parë, e as në të ardhmen, nuk kanë shumë zgjedhje, ose më saktë, zgjedhjen e vetme e kanë të përcaktohen midis të këqijave.

Prandaj, nëse një garniturë politike në pushtet do të vepronte ndryshe nga motoja e këtij teksti, dhe mendon se njerëzit harrojnë, atëherë qytetari me të drejtë do të shtrojë pyetjen: përse dhashë votën për ndryshime?!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovsja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 2 mars | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup


NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

shtojcë enigmatike e fundjavës

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

3. Futbollisti e aktori italian, Vallone
5. Pjesë e trupit, midis
7. Fshat në Tetovë
9. Muaj viti
10. Luftëtar që fshehet në mal
12. Frontal
13. Veçoj
15. Pranverë
16. Aktorja australiane, Kidman
18. Sipërfaqe e madhe ujore
20. Pjesë e trupit që kryen një funksion të caktuar
23. Bakër
24. Përdhunoj, njollos
26. Emër që i ngjitet dikujt për ta lavdëruar ose për ta fyer
28. Toka e punuar
29. Film i Isa Qoses
30. Banjë mjekuese
31. Qytet në Sudan
33. Mishërimi i një vetie
41. Element kimik
- 42. Emri i balerinës shqiptare në foto**
43. Shoshit
44. Operat e shkurta
47. Gypi i gjakut
48. Liqen në Kanada
49. Klub italian




VERTIKALISHT


1. Njësia e kapacitetit elektrik
2. Dhunë
3. Këngëtari anglez, Estli
4. Qytet në Bosnje
5. Gjarpër i trashë johelmues
6. "Mbreti" i Shekspirit
8. Ndez
9. Drejtim
11. Titull aristokratësh
12. E Belgjikës
14. Shkronja fqinje
15. Pjesa e sipërme e anijes
17. Ai që merret me kontabilitet
18. Aktori amerikan Johnny (origj.)
19. Prijësi i emirateve
21. Kalë i zi
22. Këngëtarja Istrefi
23. Reniumi
24. Çekiç
25. Lidhëz
- 27. Mbiemri i balerinës në foto**
30. Skitar
32. Shkëlqimi i ngjyrave të një stofi
33. Prapa
34. Shkronja e parë arabe
35. Ceremoni
36. Struga
37. Kruna
37. Kilo Njutën
38. Partizanja Palikuqi
39. Lista e ushqimeve
40. Aktorja sllovene, Rina
45. Arenë boksi
46. Më merr etja.

Kakuro


e lehtë



mesatare




e vështirë






LABIRINTI

Cilën rrugë duhet ta zgjedhë qeni që të arrijë deri te ushqimi?



VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!




FSHEHËSIRA

Gjej figurat që fshihen në fotografi!




DALLIMET

Gjej 7 dallimet në fotografitë e mëposhtme!




SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".




KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.




ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!




MOSBARAZIMI

Plotësoni tabelën duke u bazuar në operacionin e mosbarazimit. Përdoren numrat prej 1 deri 5.




NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



DOMINOJA e kombinuar

Në fushat e hijezuara shënioni emrin dhe mbiemrin e violinistes sonë e cila, më 16 shkurt 2018 në Milano të Italisë, mori pjesë në edicionin e trembëdhjetë të Festivalit "Rassegna Internazionale di Musica da Camera".



Anagrami

Edhe anagrami ka të bëjë me violinisten tonë në foto. Zgjidhjen e anagramit e shënioni në fushat e hijezuara.





K	E	T	B	A	S	O	L	I	R	I	
R	T	U	E	M	A	S	U	R	K	A	N
A	R	A	K	A	M	A	K		R	M	A
S	O	K	I	A	SH	K	O	S	N	S	
I	P	A	V	R	E	U	N	O	A	H	
H	E	R	U	A	N		A	R	T	A	N
T	U	M	M	A	R	B	O	LL	A	N	A
	SH	I	A		E	A	R		T	E	R
M	I	K		I	G	D		A	O	T	A
O	N		K		M	U	A		A	R	A
R	A	I	A	M	A	N		K	N	A	K
I	T	A	S		K	A	S	I	A	T	O


KATËRKAHËSHI

Pasi t'i gjeni fjalët e kërkuara, do t'ju mbeten pesë shkronja të lira, të cilat lexuar me radhë e japin emrin e përbashkët të dukurisë së fjalëve që kërkohen në këtë katërkahësh.

- | | |
|----------------|-----------------|
| AFEFOBIA | BAKTEROFOBIA |
| ALKOLOFOBIA | BATRAKOFOBIA |
| AMERIKANOFOBIA | BROMIDROSIFOBIA |
| AMFIDIAFOBIA | DEKSTROFOBIA |
| ANTROPOFOBIA | DISMORFOFOBIA |
| APARTEIDFOBIA | EREUTHROFOBIA |
| APOTEMNOFOBIA | HELIOFOBIA |
| ARPAKSOFOBIA | HELMINTHOFOBIA |
| ASASINOFOBIA | ----- |
| AUTOMISOFOBIA | |



MOZAIKU tandem



- 2 shkronja:** AK, AR, DA, IK, ME, OA, SHF, TR
3 shkronja: APE, DËM, HAP, OKA, ORO, PRO, RIN, RIP, TOK, TRI
4 shkronja: AKIL, ARIR, ASAD, ERIK, INAL, IRAK, KATE, NIPI, PARI, PRIT, TASS, TREN, TROL, URIA
5 shkronja: AJARI, ARIFIBARIU, E ETUR, ENARE, FOSIL, INARS, INATI, INENI, ISARI, LEZHAN, PETAS, RITËM, SATAR, STELA, TROFE, ULEMA, URANI
6 shkronja: ABASHUR, ANIJET, EMISAR, LEDRIK, LIKENE, PATENT, QINDAR, ROSAKU
9 shkronja: AUTORITET, ELEKTRIKE, GJUHA SHQIPE, KURESHTAR
10 shkronja: GJIROKASTRA, ELEKTROLIT, ELEMENTARE, KOTILEDONE.

"Nuk do të rrëzohemi, nuk do të pushojmë, nuk do të lëkundemi, nuk do të dështojmë". Këto fjalë aludojnë një diskurs të Churchillit në shkurt të 1941. Megjithatë në vitin 1940 në fillim të mandatit të tij, shumë nga britanikët e shihnin nën një dritë shumë ndryshe. Në ato momente ishte një 60 vjeçar i dështuar prej të cilit mbaheshin mend një numër gabimesh që kishte bërë duke mbajtur poste të rëndësishme

WINSTON CHURCHILL

DRITËHIJET E NJË UDHËHEQËSI KONTRADIKTOR



Në imagjinatën kolektive, Winston Churchill është një titan që i çoi britanikët drejt fitores në luftën kundër nazizmit. Aq shumë sa në vitin 2001 kur ndodhën atentatet e 11 shtatorit George W. Bush u foli amerikanëve: "Nuk do të rrëzohemi, nuk do të pushojmë, nuk do të lëkundemi, nuk do të dështojmë". Këto fjalë aludojnë një diskurs të Churchillit në shkurt të 1941. Megjithatë në vitin 1940 në fillim të mandatit të tij, shumë nga britanikët e shihnin nën një dritë shumë ndryshe. Në ato momente ishte një 60 vjeçar i dështuar prej të cilit mbaheshin mend një numër gabimesh që kishte bërë duke mbajtur poste të rëndësishme.

Për këtë biografi, Robert Rhodes-James në vitin 1970 do ta titullonte kështu librin mbi jetën e mëparshme të kryeministrit "Një studim mbi dështimin". Sado e pabesueshme mund të duket tani, në atë kohë flitej për një personazh pak a shumë qesharak, shqetësimi i vetëm i të cilit ishte vetëmbrojtja. Një frazë që i atribuohet lord Birkenhead-it, një nga miqtë më të mirë të tij, e sqaron më së miri karakterin ambivalent të tij: "Kur Winston ka të drejtë është unik, por kur gabohet...Ah Zot!" Në Luftën e Dytë një lord tjetër Alanbrooke iu referua vështirësisë të Churchillit për të daluar mes idealit dhe gabimit. Katalogu i vendimeve të diskutueshme nuk bazohet në zbulimin e fakteve të panjohura.

Anët e errëta të personalitetit janë mjaft të njohura. Specialistët që janë pro njohin egocentrizmin dhe guximin, besojnë se në një peshore historike duhet të peshojnë më shumë aspektet si aftësia për të udhëhequr një vend në kohë të vështira si ajo e Luftës së Dytë Botërore. Vetë Churchill-i ishte i ndërgjegjshëm për defektet e tij dhe për këtë arsye nuk mbante ditar, nuk donte të linte dëshmi për dobësitë e veta. Fëmijë i një familjeje aristokrate iu qas karrierës ushtarake, ishte i ri dhe i etur për veprimin, pasi e kishte pa-

rasysh se bëmat e tij në fushën e betejës mund të hapnin rrugën drejt politikës. Në Sudan dha ndihmën e tij pas revoltës me përmasa të mëdha të udhëhequr nga një lider fetar, mahdi. Ndërhyri në ato momente në betejën e Omdurmánit (1898) si pjesë aktive e kalorësisë së ushtrisë britanike. Do t'i rrëfente përshtypjet e tij në një libër "Lufta e Nilit", në një vepër mjeshtërore nga pikëpamja kinematografike mbi sulmin. Iidet e tij për sudanezët janë ato të një imperialisti viktorian: "Duhet të vesh rend në një territor të ndarë në tribu barbare". Popullata zezake sipas përkrahimit të tij nuk zotëron cilësi përtej vlerave dhe ndershmërisë. Në Afrikën e Jugut do të përjetonte një aventurë tjetër, këtë herë si korrespondent i luftës së Boers. U kap rob, por arriti të arratiset. U shndërrua në hero, arriti të merrte një vend

në Partinë Konservatore nga e cila do të dilte në vitin 1904 duke luajtur një lojë të rrezikshme, por që dha rezultat. E dinte që në radhët e liberalëve kishte një vend në qeveri. Si Home Secretary (ministër i brendshëm) rezultoi mjaft polemizues. Në vitin 1910 u përball me një grevë minatorësh në Uells për kushte më të mira pune. Futi ushtrinë për të frenuar revoltat me metoda efikase.

Gazetat e akuzuan për brutalitet. Biografi Alan Mooreheadi sinjalizon se ishte atëherë kur filloi mosbesimi i sindikatave kundrejt Churchillit në çështje të politikës së brendshme. Akoma më keq ishte dështimi i Galipolit pak vite më vonë, në mes të luftës përballë trupave otomane pati 250 000 humbje në radhët e ushtrisë britanike. Në atë kohë, Churchill besonte se mund ta detyronte Turqinë, aleatë të gjermanëve, të tërhiqej nga kon-

flikti në mënyrë të tillë që Londra të mund të kontaktonte me aleatët rusë përmes Detit të Zi. Fronti perëndimor mbeti i palëvizur nga lufta e llogoreve, ideja ishte hapja e një skenari të ri luftime. Megjithatë një rezistencë e paepur e çmontoi këtë plan së bashku edhe me mungesën e disiplinës së garnizoneve. Katastrofa i dha origjinë termit "sindroma e Galipolit", ngurrimi për të kryer zbakime në plazhet e kontrolluara nga armiku që u zgjat deri në Normandi tri dekada më vonë. Faji nuk ishte plotësisht i Churchillit sepse ishte kryeministri Henry Asquith që miratoi vendimet e tij. Ka edhe një fakt tjetër se Admirali injoroi këshillat e këshilltarëve dhe nuk mori masat e duhura të parandalimit. I zhgënjyer dhe me shpirt të vrarë ka të ngjarë që Churchill të merrte në konsideratë idenë e vetëvrasjes. Shkoi në Francë ku kërkoi një fat në front në mënyrë që të merrte merita për të harruar përgjegjësitë e tij.

Ishte i etur për të fshirë imazhet, sepse mendonte se ishte një i ri ambicioz që ishte ngjitur shumë shpejt në një post më të madh nga sa mund të mendonte. Përballë Gjermanisë së perandorit Guillermo II, Churchill ishte në favor të një manovre navale përmes një bllokimi që do të linte të vdisnin urie burra, gra dhe fëmijë. Gjykata e Hagës në vitin 1907 e përkufizonte këtë tak-

“Ndërroi edhe një herë partinë për t'u kthyer tek radhët konservatore.

Kryeministri Stanley Baldwin i ofroi në vitin 1925 ministrinë e Financave duke menduar se një njeri kaq dinamik sa ai ishte, më mirë ta kishte mik dhe jo kundër. Filloi atëherë që Alan Mooreheadi do ta përcaktonte si periudha me pak më shumë fat në politikë

tikë si krime luftime. E konsideronte legjitime vetëm, nëse do të përdorej për të dobësuar ushtrinë armike jo si armë kundër civilëve. E rrethuar, Gjermania reagoi duke përdorur nëndetëset. Në ato momente askush nuk diskutonte aftësinë e tij të punës, as aftësinë e tij për të mahnitur interlokutorët. Megjithatë shumë besonin se fshihte një defekt karakteri që e pengonte të sillej arsyeshëm. Kryeministri liberal, Lloyd George mendonte se mund të përfitohej nga energjia e Churchillit për aq kohë sa të mbahej nën kontroll. Për këtë arsye i dha një vend në qeveri në vitin 1917 si ministër i armatimit. Dy vite më vonë u bë sekretar i shtetit të luftës. Megjithatë nuk pati fat. Për të luftuar kundër bolshevikëve rusë që i shihte si kërcënim për demokracinë britanike urdhëroi një sulm për të kapur transiberianin. Rezultati ishte dështimi i radhës dhe sipas biografit Anthony McCarten u konsolidua ideja se ishte një aventurier ushtarak i pandreqshëm, të cilit nuk mund t'i besohej.

Pengesat nuk ia zbehën besimin tek vetja. Ndërroi edhe një herë partinë për t'u kthyer tek radhët konservatore. Kryeministri Stanley Baldwin i ofroi në vitin 1925 ministrinë e Financave duke menduar se një njeri kaq dinamik sa ai ishte, më mirë ta kishte mik dhe jo kundër. Filloi atëherë që Alan Mooreheadi do ta përcaktonte si periudha me pak më shumë fat në politikë. (History)



PAS IVANOVIQIT, NË PLAN ISHTE TË VRITEJ PRESIDENTJA KROATE

Siguria e udhëheqësve të Aleancës për të Ardhmen më të Mirë rrezikohet sipas të përditshmes në Sarajevë "Dnevni Avaz".

Sipas portalit të Sarajevës, "zbulimi i një komploti" filloi në janar pas heqjes së masave të sigurisë për shkak të ardhjes së presidentes kroate në Sarajevë dhe vrasjes së Oliver Ivanoviçit në Kosovë.

Ky portal argumenton se presidentja kroate, Kolinda Grabar Kitaroviç, vetëm për shkak të kësaj, papritmas anuloi ardhjen e saj në Sarajevë, ndërsa Igor Crnadak, ministër i punëve kufitare, ka pritur kot në aeroport.

Portali citon se shërbimet kroate kishin marrë informacion se Presidentja do të vritej.

"Sipas të dhënave operationale të MUP-it, që duhej të mbeteshin të fshehura nga publiku, Damiir Mehic e kaloi kufirin në



kalimin e Uvac më 17 janar dhe çështja ishte nëse duhej të kryente një atentat ndaj presidentit, tha portali, së bashku me duke kujtuar se një ditë më parë në Kosovë në Mitrovicë është vrarë politikani serb Oliver Ivanoviç.

Mehic ka arrestuar anëtarë të Njësisë kundër terrorizmit të Ministrisë së Brendshme të RS në hotel

"Vučko" në Jahorinë në bashkëpunim me anëtarët e MUP federale, pas së cilës i është dorëzuar Drejtorisë së Policisë Federale. Thuhet se, përveç pistoletës, tek Mehic u gjetën edhe disa dokumente origjinale të identifikimit, përfshirë letërnjoftimin e lëshuar në emër të Almir Fejzićit dhe dokumente të lëshuara në Prishtinë, në

emër të Esat Benushai.

Është alarmante, ka thënë Avaz, se Mehic kishte foton e tij në dokumentet zyrtare origjinale të BiH, por të dhënat e Almir Fejzić, i cili është gjallë dhe i cili pranoi se e dinte identitetin e tij ishin vjedhur, dhe atij nuk iu lejua ta raportonte.

Dhe, pasi e çoi në burgun e Tuzlës, Mehic dyshohet se u mburr se Osman Mehmedagic Osmic dhe Dubravko Campar, i cili udhëhoqi rastin e tij, premuan një amnisti nëse ai e hoq Radonçiqin.

Gjatë arrestimit të Mehic, u gjet një sasi e madhe parash, fati i të cilit pas konfiskimit është i panjohur.

Sipas burimeve të Avaz, kur inspektorët e Mehicit ishin intervistuar, Osman Mehmedagic Osmica, drejtor i OSA dhe Dubravko Çampara, prokuror i BiH e mirëpritën atë.

Këta janë zyrtarët me pagat më të larta në Kosovë

Në Kosovë nuk janë krerët e shtetit ndër zyrtarët më të paguar në vend. Pagën më të lartë se të Kryeministrit, Presidentit e kryetarit të Kuvendit e kanë disa zyrtarë të ndërmarrjeve publike. Disa nga ta pagën e kanë deri në 5 mijë euro. Kurse, shefi i qeverisë aktualisht pagën e ka 1 mijë e 443 euro. Drejtori i Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trust), Adrian Zalli mbetet zyrtari më i paguari në vend. Ai vazhdon të marrë pagën mujore 15 herë më të lartë se paga mesatare në vend. Zalli pagë mujore merr 5 mijë e 213 euro ose 62 mijë e 567 euro në vit. Pas Zallit, pagën më të lartë e ka Agron Mustafa, kryeshef ekzekutiv në Telekomin e Kosovës, i cili merr pagë mujore 4 mijë e 451 euro. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) merr pagë mujore 4 mijë e 301 euro ose 51 mijë euro pagë vjetore, shkruan Gazeta Monitor. Pas guvernatorit prin drejtori i menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) i cili fiton 3 mijë e 979 euro në muaj ose pagë vjetore 47 mijë e 749 euro. Keq nuk qëndron as Sejdi Hoxha, kryeshef i Postës së Kosovës, i cili merr pagë mujore 3 mijë euro. Kurse drejtori menaxhues i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) Arben Gjukaj ka pagë mujore 2 mijë e 413 euro. Ndërkaq, krerët e shtetit të Kosovës kanë pagat më të ulëta krahasuar me udhëheqësit e këtyre agjencive dhe ndërmarrjeve. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaci, merr pagën mujore 2 mijë e 800 euro, kurse kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli 2 mijë e 724 euro. Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, aktualisht pagën e ka 1 mijë e 443 euro.

Publikohet letra e Praljak para se ta pinte helmin


Motivi i të dënuarit të Hagës i vetëvrarë, i dënuar për krime lufte në Bosnje dhe Hercegovinë, Slobodan Praljak, është i qartë nga dy letra të cilat i kanë dorëzuar hetuesit e KB bashkëshortes së tij

Të dy letrat janë me datë 27 nëntor, dy ditë para shpalljes së aktgjyqimit të plotfuqishëm në lëndën Herceg-Bosna, transmeton Index.hr.

"Vendimi e ndërprerjes së jetesës në rast se shpallej fajtor e kam marrë kohë më parë – i qetë, me vetëdije dhe mirë të menduar", ka shkruar Praljak në letrën e parë, të dedikuar familjes së tij.

Siç pretendohet, në letrën e dytë ai i drejtohet bashkëshortes.

"Kaqa, mendoj që letrën "Për



familjen" do të duhet ta publikosh, në mënyrë që të pengohen thashethemet, supozimet, gënjeshtret, etj. të pafundme", ka porositur Praljak.

Avokati i tij Nika Pinter ka thënë se Praljak asgjë nuk ka bërë dhe nuk ishte nën ndikimin e emocioneve dhe ndjenja momentale.

"Për gjithçka, duke filluar

nga mbrojtja e jetës së tij ka bërë në mënyrë shumë precize, vendosmërisht dhe qetë", ka thënë Pinter.

Praljak ka pirë cianid në gjykatën e Hagës më 29 nëntor, pasi që Gjykata Ndërkombëtare për Krime Lufte për Ish-Jugosllavinë (ICTY) e konfirmoi dënimin prej 20 viteve burgim për krime lufte.

Një km rrugë në Shqipëri kushton 12.2 milionë euro

Shqipëria renditet si një ndër vendet me koston të lartë të ndërtimit të rrugëve në Evropë. Para saj është vetëm Austria.

Edhe pse mendohej se autostrada Prishtinë-Prizren kishte çmimin më të madh për kilometër, disa statistika tregojnë se këtë primat nuk e mban Kosova, por një vend fqinj i saj.

Shqipëria renditet si një ndër vendet me koston të lartë të ndërtimit të rrugëve në Evropë. Para saj është vetëm Austria, përcjell albinfo.ch.



Në bazë të një analize të bërë nga World Highway për koston për ndërtimin e autostradave rezulton se Austria shpenzon më

shumë dhe ka një kosto prej 12.8 milionë eurosh, ndërkohë që në Shqipëri një km rrugë kushton 12.2 milionë euro për kilometër.



Çitaku tregon prapaskenat në përballjet me Daçiqin

Përveç përballjeve të nxehta në fjalimet zyrtare, Vlora Çitaku tregoi se Ivica Daçiq nuk është i sjellshëm as në kohën kur nuk shihet nga kamerat. Ambasadorja e Kosovës në SHBA, Vlora Çitaku ka përfaqësuar për disa vite Kosovën në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së ku përballet me përfaqësuesin e Serbisë, Ministrin e Jashtëm, Ivica Daçiq. Në një intervistë ekskluzive për emisionin "Jeta në Kosovë", Vlora Çitaku tha se shumë herë gjatë fjalimeve të saja, i bie të dëgjojë tone të ashpra, madje edhe të shara nga Ivica Daçiq. "Është një situatë shumë e pakëndshme, bashkëbiseduesi im nga Serbia është shumë i padurueshëm. Janë disa gjëra që nuk kapen nga kamerat dhe mikrofonat por ai tërë kohës sa unë flas ai bërtet. Ndonjëherë përdor edhe fjalë të rënda, gjuan fjalë në gjuhën serbe. Më thotë gënjeshtar, po rren, nuk është e vërtetë edhe shan, ndonjëherë edhe me tone të rënda", tha Çitaku.

Çitaku tha po ashtu se është kundër mbajtjes së këtyre seancave për shkak se sipas saj çdo seancë është një mundësi për Serbinë që të prezantojë Kosovën si një çështje të pazgjidhur brenda OKB-së. Në këtë emision mund të ndiqni një kolazh të përballjeve të dy bashkëbiseduesve nga Kosova dhe Serbia në Këshill të Sigurimit ku ndër të tjera Çitaku ia kujton Daçiqit statusin e Kosovës dhe faktin se historia është e pakthyeshme. /kallxo.com/

Kjo statistikë është nxjerr duke u bazuar në përllogaritjet e çmimit për ndërtimin e rrugës Thumanë-Kashar. Qeveria shqiptare parashikon ndërtimin e një sërë segmentesh rrugore në Shqipëri në bashkëpunim me privatën për të cilat kostoja e parashikuar është e lartë.

Pavarësisht koston të lartë të ndërtimit të autostradave në Shqipëri problem mbetet mirëmbajtja e tyre pasi fondet e vëna në dispozicion janë shumë të vogla.



SHBA-RUSI, NJË GARË E RE ARMËSH

Nëse nuk ka nisur, një garë e re armësh është gati të nisë, thonë analistë dhe ekspertë për kontrollin e armëve.

Të enjten, presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, tha se Rusia ka zhvilluar armë të reja strategjike, përfshirë një raketë me fuqi bërthamore, e cila, sipas tij, mund të fluturojë për kohë të pacaktuar dhe të shmangë mbrojtjen raketore të Shteteve të Bashkuara. Me këtë deklaratë, Putin rrëmbu vëmendjen e politikëbërësve, ekspertëve ushtarakë dhe ligjvënësve nga Uashingtoni në Berlin.

Moska dhe Uashingtoni, që kanë rreth 93 për qind të armëve bërthamore në botë, kanë ndryshuar politikën në lidhje me arsenalin.

“Në dhjetë vjetët e fundit, sidomos, regjimi i kontrollit të armëve që kemi trashëguar nga Lufta e Ftohtë është, është në stres të madh”, thotë për Radion Evropa e Lirë, John Baker, analist dhe strateg në Fondacionin Ploughshares – një grup që mbështet çarmatimin.

“Jemi në fillim të një gare të re armësh”, paralajmëron ai.

Putin u mburr veçanërisht me armët me kapacitet bërthamor, si ato në shërbim, ashtu edhe ato në zhvillim, të cilat i prezantoi në fjalimin e tij gati dyorësh para ligjvënësve dhe zyrtarëve të tjerë rusë.

Matthew Kroenig, profesor në Universitetin Georgetown dhe autor i librit Logjika e Strategjisë Amerikane Bërthamore, thotë

se SHBA-ja dhe Rusia tashmë janë në garë armësh, pavarësisht nëse Uashingtoni është në dijeni ose jo.

“Rusia ka qenë në garë armësh me SHBA-në gjatë dekadës së kaluar, por ne tani jemi duke u zgjuar nga ky fakt. Pra, ne mund të hyjmë në garë të re armësh, por ky nuk është rezultati më i keq i mundshëm. Rezultati më i keq është të mos bëjmë asgjë derisa armiku ndërton armë për t’u angazhuar në agresion ndaj jush dhe aleatëve tuaj”, thotë Kroenig.

Analisti Stephen Schwartz, autor i librit Kostoja dhe Pasoja të Armëve Bërthamore të SHBA-së, thotë se raketa me fuqi bërthamore, e prezantuar nga Putini, i ngjan një arme amerikane të testuar në vitet 1950 dhe 1960.

“Ka qenë një koncept i keq. Reaktori ka qenë i pambrojtur dhe lëshonte nivele të rrezikshme të rrezatimit”, thotë Schwartz.

Pavel Podvig, studiues zviceran i armëve ruse, thotë për Radion Evropa e Lirë se nuk duhet tërhequr paralele me armatimin që ka definuar marrëdhëniet amerikano-sovjetike në fund të viteve 1950 ose në vitet '80.

“Nuk është një garë armësh në kuptimin që nuk trondit asnjë balancë dhe nuk rrit numrin e raketave dhe kokave bërthamore. Këto sisteme patjetër se do të kom-

plikojnë situatën dhe aksidentet do të jenë më të mundshme”, thotë Podvig.

Putin, në fjalimin e së mërkurës, përmendi në mënyrë të veçantë Traktatin Raketor Anti-Balistik, i cili ka kufizuar aftësinë e Moskës dhe të Uashingtonit të zhvillojnë sisteme të mbrojtjes raketore. Traktati i vitit 1972 ka qenë një nga marrëveshjet më të rëndësishme të Luftës së Ftohtë, sepse mbrojtja raketore është besuar se është destabilizuese në mënyrën se si dy vendet llogarisin strategjitë bërthamore.

Në vitin 2002, presidenti i atëhershëm amerikan, George W. Bush, është tërhequr njëanshëm nga traktati. Putin në atë kohë ka thënë se vendimi është i gabuar, porse Moska nuk mund të bëjë gjë.

Në fjalimin drejtuar kombit, në janar, presidenti amerikan, Donald Trump, tha se Kongresi “do të modernizojë dhe rindërtojë arsenalin bërthamor”.

“Putin e përshkroi arsyetimin për armët e reja kryesisht me premtimet e thyera të SHBA-së në kontrollin e armëve dhe me paranojën nga sistemet amerikane të mbrojtjes raketore”, thotë Kingston Reif, analist në Asociacionin për Kontrollin e Armëve.

“Rusia dhe Shtetet e Bashkuara po shkojnë drejt një rruge destabilizuese dhe të panevojshme”, paralajmëron ai. /Rel/



Kërkohen hetime nga OKB-ja të sulmeve kimike në Siri

Ambasadorja e SHBA-së tha se dëshiron që Këshilli i Sigurimit të ngrejë një ekip të ri hetues Uashingtoni tha se po përpiqet të nxisë Kombet e Bashkuara që të nisin një hetim të ri të sulmeve me armë kimike në Siri – tre muaj pasi Rusia shkatërroi hetimin e mëparshëm të OKB-së. Ambasadorja e SHBA-së në OKB, Nikki Haley, tha se dëshiron që Këshilli i Sigurimit të ngrejë një ekip të ri hetues, që do të përcaktonte se kush qëndron prapa sulmeve kimike në Siri. Komentet e saj vijnë pas raporteve për përdorim të gazit të klorit në enklavën e Gutas Lindore të Sirisë, në javët e fundit. Haley tha se shpreson se Këshilli i Sigurimit do të votojë për masën në fillim të javës së ardhshme. Një hetim i mëparshëm i OKB-së përfundoi në nëntor, pasi Rusia u vuri veto përpjekjeve për të rinovuar mandatin e tij. Rusia këmbëngul se ky ekip hetues ka qenë i njëanshëm dhe kundër aleatit të saj, presidentit sirian, Bashar al-Assad. Damasku thotë se ka hequr dorë nga përdorimi i armëve kimike.



Dhjetëra të vdekur nga zjarri në Baku

Njëzetedy njerëz kanë vdekur nga zjarri në një qendër të rehabilitimit nga droga në kryeqytetin e Azerbajxhanit, Baku.

Zyrtarë të Ministrisë së Shëndetësisë kanë thënë se tre persona janë shtruar në spital.

Shkaku definitiv i zjarrit nuk dihet ende, edhe pse një deklaratë zyrtare e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, e Ministrisë së Shëndetësisë dhe e asaj të Brendshme thotë se dyshimet bien mbi rrjetin e energjisë elektrike.

Ministria e Emergjencave tha se zjarri është shuar dhe se detaje të tjera do të jepen më vonë.

Zyrtarë të lartë të shtetit kanë shkuar në vendin e ngjarjes.

Sulmohet autokolona e NATO-s në Kabul



Një mjet i improvizuar shpërthyes është aktivizuar pranë autokolonës së forcave të NATO-s në kryeqytetin afgan Kabul, me ç’rast të paktën 4 persona janë plagosur

Zëdhënësi i Ministrisë së Brendshme të Afganistanit, Najib Danish, konfirmoi për AA se sulmi ka ndodhur në vendbanimin Binaey, rreth 10 kilometra nga baza e NATO-s në Kabul, raporton AA.

Siç tha ai, objektivi i sulmit supozohet të ketë qenë autokolona e NATO-s.

Ende askush nuk e ka marrë përgjegjësinë për sulmin deri më tani. Sulme të ngjashme kanë ndodhur edhe më herët, ndërsa përgjegjësinë për to e kanë marrë talebanët dhe grupet e armatosura që mbështesin DEASH-in.

LULZIM HAZIRI VJEN NË MAQEDONISHT



Do isha shumë i lumtur nëse ky libër rrit një debat interkulturore, një bashkëpunim më të ngushtë jashtë atyre skemave të imponuara nga politika, sepse letërsia mbi të gjitha duhet të jetë sigurisht, që ka të bëjë edhe me të bukurën dhe kisha dashur që çdo rezultat të jetë i bukur nga ky botim”, - theksoi autori i librit, Lulzim Haziri.

Të mërkurën në Shkup është promovuar libri në gjuhën maqedonase “Kur dashuria shkrihet si shkumës” i poetit Lulzim Haziri. Libri është sjauar nga një përzgjedhje poezish të shkruara nga autori në periudha të ndryshme, kurse një sharm të veçantë atyre iu dha përkthyesja Lindita Ahmeti.

Për këtë vepër letrare të Lulzim Hazirit kanë folur Luan Starova dhe Salajdin Salihu.

“Ai është një zë i mjaft autentik në poezinë shqipe në përgjithësi që botohet tek ne shqiptarët në Maqedoni, një zë i fuqishëm që përmban në vete

dhe vlera estetike, por është në rrydhojë me pulsimin e jetës bashkëkohore dhe besoj se lexuesi maqedonas do të ketë në vazhdimësi edhe një vepër në letërsinë shqipe e cila do të hap rrugën e të tjerëve”, - tha akademiku Starova.

Ndërkaq për dimensionin interkulturore të këtij libri ka folur Salajdin Salihu.

“Unë mendoj që sistemet kulturore, sistemet poetike kanë shumë nevojë që të komunikojnë mes vete dhe është një ngjarje që na fut në dimensionin interkulturore, që është shumë e domosdoshme për

këtë shoqëri siç është Maqedonia, sepse në njëfarë mënyre komunikojmë me vlera. Mendoj që është bërë një punë e jashtëzakonshme në komunikimin e vlerave artistike që krijohen nga krijues shqiptarë me sistemin kulturor maqedonas, që duhet të ishte dhe anasjelltas”, - ka vlerësuar Salajdin Salihu.

Ndërkaq, Haziri theksoi se ky libër u bën nder edhe lexuesve maqedonas të cilët do kenë mundësi të afrohen edhe me një poet shqiptar që jeton afër tyre.

“Është kjo një vënie e një ure mes dy kulturave, dy gjuhë-

ve dhe besoj se ky botim i poezisë shqipe në gjuhën maqedonase do të ndikojë në atë hapësirë interkulturore, pasi që njihemi shumë pak njëri me tjetrin, shumë pak bashkëpunojmë dhe do isha shumë i lumtur nëse ky libër rrit një debat interkulturore, një bashkëpunim më të ngushtë jashtë atyre skemave të imponuara nga politika, sepse letërsia mbi të gjitha duhet të jetë sigurisht, që ka të bëjë edhe me të bukurën dhe kisha dashur që çdo rezultat të jetë i bukur nga ky botim”, - theksoi autori i librit, Lulzim Haziri.

Ja lista e prezantuesve në Oscar 2018

Na ndajnë vetëm edhe disa ditë nga ceremonia e Oscar 2018, dhe tashmë shumë prezantues janë zbuluar.

Prezantuesit e sapo-shpalur të famshëm përfshijnë, Emma Blunt, Sandra Bullock, Dave Chappelle, Eugenio Derbez, Ansel Elgort, Jane Fonda, Jodie Foster, Eiza González, Ashley Judd, Nicole Kidman, Matthew McConaughey, Helen Mirren, Rita Moreno, Lupita Nyong'o dhe Christopher Walken.

Ceremonia mbahet më 4 mars dhe do të drejtohet nga Jimmy Kimmel.

Nominimet për edicionin e 90-të të “Oscars” janë bërë ta-

shmë të ditura.

Akademia publikoi sot listën e nominimeve për filmat dhe aktorët të secilës kategori.

“The Shape of Water” është filmi i cili prin me 13 nominime, pasuar nga filmi epik i luftës “Dunkirk” me gjithsej tetë nominime.

Filma të tjerë që gjithashtu

kanë më së shumti nominime janë “Three Billboards Outside Ebbing, Missouri” me shtatë, dhe “Lady Bird” dhe “Blade Runner 2049”, përkatësisht me nga pesë nominime.

Lista e aktorëve përfshinin disa prej emrave më të mëdhenj në biznes: Denzel Washington, Meryl Streep dhe Allison Janney.

Por disa talente të rinj u ndërruan gjithashtu me nominime, ndër ta edhe: Saoirse Ronan, Daniel Kaluuya dhe Timothée Chalamet, shkruan BBC.

Nata e ndarjes së çmimeve “Oscars 2018” do të mbahet më 4 mars 2018 në teatrin “Dolby” të Los Angeles, në Kaliforni, me nikoqir Jimmy Kimmel.

ZJARR DHE TËRBIM

BRENDA SHTËPISË
SË BARDHË TË TRAMPIT



MICHAEL WOLFF

“Fire and Fury”, tani edhe në shqip

Shtëpia botuese BOTA SHQIPTARE publikoi “Zjarr dhe Tërbim”, libri që po shkund Shtëpinë e Bardhë, një libër i quajtur si fenomeni i botimeve të këtij fillim-viti.

Prapaskena të bujshme, sekrete familjare dhe “të dhëna konfidenciale për Trampin”: bestselleri që tronditi presidentin. Libri, i dalë në SHBA më 5 janar dhe i shitur fillimisht në 150.000 kopje, ka arritur tashmë 2 milion kopje të ezauruara fizike – me lexuesit që mbajnë radhë gjatë natës përpara librarive si në kohën e Harry Potter-it – përveç qindra mijëra kopjeve në versionin e-book dhe audio. Në Angli, brenda pak ditësh, madje edhe para ardhjes në libraritë më 10 janar, u shitën 400.000 kopje dhe tashmë më shumë se 35 vende kanë marrë të drejtën për ta botuar. Në Francë, libri, siç njoftohet nga gazeta “Le Figaro”, do të dalë më 22 shkurt nga botimet Laffont. “Gënjeshtër? “Gjithçka është e vërtetë”, siguron autori Michael Wolff, i cili fillimisht e ideoi librin si një vlerësim të 100 ditëve të para në Shtëpinë e Bardhë me synimin për ta botuar në vitin e parë të presidencës Trump por, më pas, krejtësisht papritur, pati qasje te Presidenti dhe te anëtarët më të lartë të stafit të tij, përfshirë Stiv Benon, gjatë 18 muajve (intervista e parë u zhvillua në maj 2016), duke u bërë një “depërtues i vazhdueshëm” në Shtëpinë e Bardhë.

Wolff vëzhgon nga një perspektivë e veçantë kaosin e Zyrës Ovale dhe nxjerr nga duart një libër shpërthyes, të pasur me prapaskena të padëgjura.

· A mendonte vërtet Trampi se do të fitonte? E donte vërtet këtë? Cilat janë qëllimet e “Xhervankës”, krijesa dykokëshe e përbërë nga e bija, Ivanka, dhe dhëndri Xherid Kushner?

· Pse u shkarkua shefi i FBI-së Xhejms Komi dhe, pas tij, shefi i stafit Rins Prius?

· Pse u shkarkua Stiv Benoni, strategu (dhe shpirti i zi) që i dha fitoren Trampit?

· Kush është “zëri” që tregon për takimet mes stafit të Trampit dhe rusëve?

· Pse është e kotë t’i ofrosh Trampit relacione, analiza dhe çfarëdolloj teksti të shkruar?

· Kush e drejton vërtet Shtëpinë e Bardhë?

“Zjarr dhe Tërbim” është libri që Trampi u përpoq më kot ta bllokonte, një fenomen botëror që tregon historinë pasionante të një mandati të paparashikueshëm dhe të vrullshëm si vetë presidenti.

LIGA E PARË, JAVA E 22

KUQEZINJTË TË BINDUR NË FITORE NDAJ POBEDËS

Grupi në dispozicion të trajnerit Qatip Osmani (në përjashtim të Fazllagiq dhe Zejnullait) është i plotë dhe nga ata kërkohet që të vazhdohet seria e fitoreve. Derisa, asnjëri nga lojtarët nuk beson në ndonjë dështim eventual në këtë përballje



Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 2 mars - Fitorja ndaj Akademija Pandevit në minutat e fundit, ka rritur entuziazmin tek skuadra e Shkëndijës në prag të ndeshjes së sotme (e shtunë) ndaj Pobodës në stadiumin e qytetit në Tetovë. Grupi në dispozicion të trajnerit Qatip Osmani (në përjashtim të Fazllagiq dhe Zejnullait) është i plotë dhe nga ata kërkohet që të vazhdohet seria e fitoreve. Derisa, asnjëri nga lojtarët nuk beson në ndonjë dështim eventual në këtë përballje. "Vazhdojmë të marrim sfidat njëra pas tjetres dhe tani pason përballja me Pobodën. Në rrugën drejt titullit secila ndeshje

ka vlerën e saj dhe për këtë arsye për ne më e rëndësishme është kjo që pason. Jemi të përgatitur për të dhënë më të mirën në kërkim të fitores së re përballë një rivali që e respektojmë dhe që nëse e nënçmon din të bëjë probleme. Besoj se ne nuk do të lejojmë diçka të tillë, do të dalim në fushë me koncentrim, respekt dhe angazhim maksimal për të bërë lojën tonë, e cila kur është në nivelin e duhur siguri sht se nuk pritet të kemi problem për të arkëtuar tre pikët", tha për gazetën KOHA, shtylla e mbrojtjes së kuqezinjve Visar Musliu.

Ndryshe, sfida mes Shkëndijës dhe Pobodës është e vetmja që do

të zhvillohet sot (e shtunë), përballjet tjera do të zhvillohen të dielën. Spikat përballja mes FC Shkupi dhe Rabotniçkit, e cila do të zhvillohet në stadiumin "Boris Trajkovski" në lagjen Maxhari. Një përballje mjaftë e rëndësishme për bardhekaltërit, por edhe për skuadrën e Rabotniçkit, duke i marr parasysh synimet që i kanë ata. Trajneri Ardian Nuhiu në përjashtim të Ermedin Adem (karton i kuq) dhe Stefan Vujçiq (i lënduar), në dispozicion do të ketë më të mirët me shpresë se do të arrijnë të marrin maksimumin nga kjo përballje. "Na pret një ndeshje mjaft e rëndësishme dhe tani jemi në një

JAVA E 21, TAKOHEN:
E SHTUNË:
SHKËNDIJA - POBEDA

E DIEL:
PELISTERI - SKOPJE
VARDARI - SILEKSI
SHKUPI - RABOTNIÇKI
A. PANDEV - RENOVA

fazë që të gjitha ekipet po kërkojnë të shkëputen njëra nga tjetra, pasi që diferenca e pikëve është shumë e ngjeshur. Jemi të vetëdijshëm se kampionati është shumë i fortë dhe nuk ka ekipe të dobëta, andaj respektojmë secilin kundërshtarë. Ndjaj Rabotniçkit nuk kemi se çka

REFUZOHET ANKESA E A.PANDEVIT

Nuk ka pasur shkelje të rregullit nga rregullorja për gara në FFM. Ndërkaq, rezultati regjistrohet me rezultatin 1-0, rezultat i cili u arrit gjatë 90-të minutave të zhvilluara në Tetovë në sfidën mes Shkëndijës dhe Akademia Pandevit. Kështu vendosi të premtën Komisioni Disiplinor, duke hedhur kështu poshtë ankesën e skuadrës së A.Pandev dhe duke e mbyllur të njëjtën.

të kalkulojmë, e kemi kundërshtarë të drejtpërdrejtë dhe mendojmë vetëm për fitore. E mira e jonë është se ngadalë ekipi po kompletohet, pasi kishim futbollistë të lënduar dhe ata që erdhën në afatin e janarit kishin nevojë për tu adaptuar me të tjerët. Besoj se do të kemi paraqitje të mirë dhe do të gëzojmë tifozët tanë", deklaroi Besart Krivanjeva.

Skuadra tjetër shqiptare Renova, pas tre barazimeve të njëpansnjëshme, në cilësinë e mysafirit do të përballet me skuadrën e Akademija Pandevit. Derisa, kampioni aktual Vardari do të jetë nikoqir i Sileksit. të gjitha ndeshjet zhvillohen në ora 14.00.

Të punojmë, marrim përvojë dhe të bëjmë progres

Bernard Çallandes edhe zyrtarisht do të jetë trajneri i ri i përfaqësueses kosovare të futbollit. Ai është prezantuar dje nga presidenti i FFK-së, Fadil Vokrri. Për ata që nuk e njohin zviceranin, ai ka drejtuar në klube të ndryshme helvete, si Cyrih, Jang Bojs dhe Sion, por në karrierë ka drejtuar edhe kombëtaren e Armenisë. "Çallandes ka një histori impresionuese, ka punuar me klube të njohura zvicerane, pastaj në përfaqësuesen e Armenisë. Për situatën momentale të kombëtares së Kosovës, mendoj se është një


zgjedhje e qëlluar", tha Vokrri në fjalën e prezantimit. Nga ana e tij, trajneri zviceran është shfaqur i lumtur në ditën e zyrtarizimit në krye të kombëtares së Kosovës. "Faleminderit për besimin. Për mua është një kënaqësi e madhe që do të punoj për Kosovën. Ekipi është i ri. Deri më tani keni bërë punë të madhe. Por, duhet të punojmë edhe më shumë, të marrim përvojë, të bëjmë progres", deklaroi Çallandes. Bernard Çallandes ka nënshkruar një kontratë 2-vjeçare me Federatën Kosovare të Futbollit.



BOTËRORI I ATLETIKËS

Gega, përfaqësuesja e vetme e Shqipërisë

Këtë të enjte ka nisur Botërori i 17 i Atletikës për salla të mbyllura, që zhvillohet në Birmingem të Anglisë. Rreth 600 atletë nga 150 vende të ndryshme do të garojnë në "Birmingham Arena" për 4 ditë me radhë, deri ditën e diel, kur do të zhvillohen disa nga finalët kryesore. Sa i përket vendit Shqipërisë ajo do të përfaqësohet me vetëm një sportiste, e ajo është Luiza Gega, e cila do të marrë pjesë në garën e 1.500 metrave. Siç ndodh rëndom edhe në këtë Botëror, Gega është larguar me një sërë kritikash dhe pakënaqësish nga Federata Shqiptare e Atletikës, apo ndoshta edhe nga shteti, ku sa i përket të parës, nëpërmjet një fotoje në "Instagram" ka theksuar sesi ka shpenzuar vetë për uniformën, ndërkohë që në një foto tjetër, me të mbërritur në Angli rithekson kushtet e vështira në të cilat është stërvitur. Kategoria e 1.500 metrave u zhvillua dje pasdite, që do të jetë edhe dita e dytë e këtij Botërori. Ndërkohë, sa i përket kampionit tjetër të Ballkanit, Izmir Smajlag,



ai në këtë Botëror do të jetë vetëm një i ftuar si shikues, pasi është tërhequr nga gara duke ruajtur fizikun e tij, që sipas mjekut ka nevojë për pushim. Ai pretendon të jetë gati për Lojërat Mesdhetare që do të zhvillohen në Terragona të Spanjës, në muajin qershor, e më pas për kampionatin Evropian, që do të zhvillohet në muajin gusht, ku do të përpiqet që të ruajë titullin që mban, edhe pse ky Evropian i Berlinit nuk do të jetë më në salla të mbyllura. Sa i përket Botërorit

të Birmingamit, përfitimet financiare do të jenë në shifra shumë të larta, duke filluar nga 2 milionë dollarë që janë në dispozicion të fituesve të 6 kategorive të ndryshme, për të kaluar te 20 mijë dollarë për vendin e dytë, 10 mijë dollarë për vendin e tretë, 8.000 dollarë për vendin e katërt, 6.000 për të pestin dhe 4.000 dollarë për vendin e gjashtë. Për çdo atlet që do të arrijë të thyjë një rekord do të ketë një shtesë prej 50 mijë dollarësh bonus.



Mbrojtësi i Skënderbeut, Bajram Jashanica, ka rezultuar pozitiv në kontrollet antidoping dhe do të mungojë për një kohë të gjatë. 27-vjeçari nga Prishtina, i cili ka luajtur 145 ndeshje me fanellën e klubit korçar, është zbuluar pozitiv pas kontrolleve të kryera në shtator, pas ndeshjes Skënderbeu-Jang Bojs në Liga Evropë. "Sport Ekspres" mëson se tashmë në zyrat e klubit korçar ka mbërritur edhe e-maili zyrtar që njofton Skënderbeun, por edhe Federatën Shqiptare të Futbollit, në lidhje me substancën e ndaluar që është përdorur nga Jashanica, i cili pezullohet për dy vite. Natyrisht, në raste të tilla nevojitet edhe testi B, por edhe aty rezultati ka qenë i njëjtë

SUBSTANCA

Sipas rregullores në kupat e Evropës, klubet janë të informuar se pas çdo takimi dy lojtarë me short të rastësishëm i nënsh-

JASHANICA REZULTON POZITIV NË TESTIN PËR ANTIDOPING

RREZIKON 2 VITE PEZULLIM

Thuhet se tashmë në zyrat e klubit korçar ka mbërritur edhe e-maili zyrtar që njofton Skënderbeun, por edhe Federatën Shqiptare të Futbollit, në lidhje me substancën e ndaluar që është përdorur nga Jashanica, i cili pezullohet për dy vite. Natyrisht, në raste të tilla nevojitet edhe testi B, por edhe aty rezultati ka qenë i njëjtë

trohen testit antidoping. Në dy pjesëmarrje në fazën e grupeve, Skënderbeu nuk kishte pasur asnjë rast pozitiv, deri tani, sepse nga UEFA ka ardhur njoftimi se Jashanica ka pasur një masë jashtë normales të substancës Prednisolol, ose Prednisolon. Bëhet fjalë për një glukokortikoid (steroid) që jepet vetëm me recetën e mjekut. Është një substancë që përdoret për të ndihmuar në shërimin e inflamacioneve në zona të ndryshme të trupit, ndërkohë që përdoret edhe për kurimin e problemeve të ndryshme, si enjtja e goditjeve apo plagëve, alergji serioze, asmë, probleme me gjakun apo palcën kurizore, probleme me shikimin, probleme lëkure e të tjera. Problemi është se kjo substancë është në listën e medikamenteve të ndaluara "WADA", Agjencia Botërore Anti-Doping, ndaj pezullimi është i paevitueshëm.

DËNIMI

Duke qenë se ka rezultuar pozitiv më 28 shtator 2017, tashmë Jashanica do të mungojë deri në fund të vitit 2019, që është një lajm i tmerrshëm për të dhe për Skënderbeun. Jashanica është në kulmin e karrierës dhe në moshën 27-vjeçare është bërë një titullar fiks edhe te Kosova, ku ka luajtur 4 ndeshje nga minuta e parë vjeshtën e shkuar. Më herët këtë sezon Jashanica ka pasur probleme fizike dhe këtë sezon disa herë ka luajtur duke u sforcuar, ndaj ndoshta është nevojitur ndonjë mjekim për të përballuar dëmtimet. Ndërkaq, në këtë moment Jashanica është sërish i dëmtuar, pasi

klubi ka informuar se mbrojtësi është dashur të operohet dhe do të mungojë rreth një muaj e gjysmë. Sido që të jetë, tashmë Jashanica është i detyruar të pushojë dhe të riaftësohet pa pasur presionin e kthimit në fushë.

EARDHMJA

Një mungesë dyvjeçare do të thotë që mbrojtësit i prishet karriera, sepse gjatë vitit të fundit ka qenë shpesh pranë shitjes në kampionate të rëndësishëm, por asgjë nuk është arritur, për faktin se Skënderbeu ka kërkuar gjithnjë shifra të rëndësishme, duke nisur nga 500 mijë euro. Tashmë gjithçka merr fund dhe sapo UEFA të bëjë publik ven-

dimin, është e qartë që do të mbyllet çdo dritare transferimi gjetkë. Ekziston mundësia që Skënderbeu dhe lojtari të komunikojnë me UEFA-n dhe organet antidoping, për të pretenduar pafajësinë dhe përdorimin e substancës pa qenë në dijeni që ishte në listën e substancave të ndaluara, por sido që të shkojë, e shumta që Jashanica mund të përfitojë, është 5-6 muaj ulje dënimi, për faktin se nuk ka precedent doping, ashtu si Skënderbeu. Natyrisht, duhet ndërtuar një strategji e mirë mbrojtëse, për të vërtetuar arsyen e marrjes së medikamentit dhe mungesën e dijenisë nga ana e mjekëve për ndalimin e përdorimit të saj.

Publicitet

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/2015 – tekst i pastruar), nenit 102 alineja 1 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18), Pëlqimit nr. 18-598/2 të datës 12.02.2018 të Ministrisë së Financave dhe nenit 12, nenit 16 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "PRANVERA" f. Vrapçisht, u.d drejtori i IPKÇF "Vrapçisht" f. Vrapçisht, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim për kohë të pacaktuar

- Tre (3) persona për vendin e punës përkëdhelës – ofruet të shërbimeve të nivelit të parë B për kohë të pacaktuar,
- Dy (2) persona edukatore - ofruet të shërbimeve me kohë të pacaktuar,
- Një (1) person kuzhinier- gjellëbërës, me kohë të pacaktuar,
- Një (1) person për vendin e punës ndihmës kuzhinier- gjellëbërës,
- Një (1) person ndihmës-teknik të nivelit të tretë A për kohë të pacaktuar

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përcaktuara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015, 150/2015, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18) kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Për vendin e punës përkëdhelës:
 - Arsim të mesëm të mbaruar katër vjeçar;
 - Licencë valide për përkëdhelës
 - Me dhe pa përvojë pune
 - Orari ditor i punës është prej ora 08,30 deri në ora 16,30
 - Neto pagesa fillestare: 14.780,00 denarë.
- Për vendin e punës ndihmës gjellëbërës:
 - Arsim fillor ose të mesëm të mbaruar;
 - Me dhe pa përvojë pune
 - Orari ditor i punës prej ora 06,00 deri në ora 14,00
 - Neto pagesa fillestare: 12.000,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Dëshmi për arsim të mbaruar që kërkohet (original ose kopje të vërtetuar në noter);
- Licencë valide për përkëdhelës (vetëm për vendin e punës përkëdhelës)
- Certifikatë të shtetësisë (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Vërtetim të mjekut se personi është i shëndoshë psiko-fizikisht;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Dëshmi se nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë është dënuar për një krim të dhunës në familje, heqjes së një të mitur, neglizhenca apo abuzimi i një të mituri apo incestit, një krim nga grupi i veprave penale kundër lirisë gjinore duke pasur parasysh sanksionin i vënë dhe në të cilën sipas ligjit përcaktuar sjelljen diskriminuese (jo më të vjetër se 6 muaj).

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

Vendimi për zgjedhje do të sillet në afat prej 15 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitjen në lidhje me shpalljen.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtrura pas afatit nuk do të merren parasysh.

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri në: IPKÇF "PRANVERA" f. Vrapçisht, Komuna e Vrapçishtit. Kontakt mob: 070/326-972

IPKÇF "PRANVERA" f. Vrapçisht
u.d Drejtor
Nevrie DALIPI

Publicitet

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Teksti i pastruar – Gazeta Zyrtare e RM nr. 52/2012, nr. 54/13), nenit 24, 25 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për zhvillim të barabartë rajonal (Gazeta Zyrtare e RM nr. 63/07, nr. 187/13, nr. 43/14, nr. 215/15), publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të Udhëheqësit të Qendrës për zhvillim të Rajonit planor të Pellagonisë
-1 realizues për kohë të caktuar të punës (për periudhë prej 4 vjet)

1. Qendra për zhvillim të Rajonit planor të Pellagonisë ka nevojë për punëtor për themelimin të marrëdhënies së punës për vendin e punës

1. Udhëheqës të Qendrës për zhvillim të Rajonit planor të Pellagonisë 1 realizues

Krahas kushteve të përgjithshme për punësim të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- PSP të mbaruar shkalla VII/1 ose së paku 240 kredi të arritura sipas SETK
- Njohuri të politikave për zhvillim të barabartë rajonal dhe sistemin e vetëqeverisjes lokale
- Njohuri aktive të gjuhës angleze
- Njohuri të punës me kompjuter
- Përvojë në punë me projekte vendore dhe ndërkombëtare
- Udhëheqësi i Qendrës për zhvillim të Rajonit planor të Pellagonisë është me mandat prej 4 vjet.
- Dokumentet e nevojshme për aplikim:
 - Certifikatë të shtetësisë
 - Diplomë për arsimin e mbaruar në original ose kopje të vërtetuar
 - Dëshmi për njohje aktive të gjuhës angleze
 - Dëshmi për njohje të punës me kompjuter
 - Biografi (CV)
 - Letër motivimi

Shpallja është e hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor, pa përshirë edhe ditën e publikimit. Orari javor i punës është prej ditës së hënës deri ditën e premte, prej ora 08.00 deri në ora 16.00. Pauza prej ora 11.00-11.30. Neto pagesa fillestare 37.289,00 denarë.

Fletëparaqitja, së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri tek Kryetari i Këshillit për zhvillim të Rajonit të Pellagonisë, M-r Natasha Petrovska në adresë: Bul. "1-vi Maj" nr. 61 (Komuna e Manastirit) me shenjë për "Shpallje publike". Telefoni 047-208-340.

Punëdhënësi do të realizojë zgjedhje në afatin e caktuar me nenin 23 paragrafi 2 të LMP.

Ndaj kandidatit të zgjedhur pas zgjedhjes së realizuar, do të realizohet kontrolli për aftësinë shëndetësore dhe psiko-fizike nga ana e institucionit të autorizuar në barrë të punëdhënësit.

Dokumentin – certifikatë për aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës punëdhënësi do ta sigurojë përmes detyrës zyrtare.

Fletëparaqitjet të cilat nuk do të parashtrohen deri në afatin e caktuar dhe fletëparaqitjet që nuk i përmbajnë dokumentet e kërkuar do të konsiderohen si të vonuara gjegjësisht të pakompletuara dhe të njëjtat nuk do të shqyrtohen.

Kryetari i Këshillit për zhvillim të Rajonit planor të Pellagonisë
M-r Natasha Petrovska

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar Po + Pr + 2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për realizim të ekskursioneve për nxënës dhe Programit për realizim të ekskursioneve, Komisioni për grumbullim të ofertave për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm për realizim të ekskursioneve për nxënës pranë SHFK "Sv. Kliment Ohridski" Dellçevë, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për grumbullim të ofertave për organizim të ekskursioneve për nxënës

- Ekskursion njëditor për nxënësit e klasës së III;
- Ekskursion dyditor për nxënësit e klasës së VI;
- Ekskursion treditor për nxënësit e klasës së IX.

Ekskursionet do të realizohen në muajin 04 dhe 05.2018.

Programet për ekskursione do t'i kërkonin në e-mail ousvklhohridskidelcevo@yahoo.com dhe në tel. 078-267-544

Ofertat me shkrim (veç e veç për secilin ekskursion) duhet të përpilohen dhe të dorëzohen në pajtim me kërkesat e theksuara në shpallje dhe në të njëjtat duhet të shënohet: emri i subjektit juridik, nënshkrim të personit përgjegjës dhe vullë, çmimi të veçantë dhe të përgjithshëm të shërbimeve, në të futet (akomodimi, transporti, ushqimi) dhe siguri të posaçmë të nxënësve, mënyra të pagesës, kushte për volitshme për nxënësit që vijnë nga familjet e prekura sociale, guidë, numër të mësimdhënësve dhe mjek.

Ofertat me shkrim nuk duhet të përmbajnë zgjedhje alternative.

Oferta e cila përmban elemente ose shërbime plotësuese nuk do të ketë përparësi gjatë evaluimit të së njëjtës.

Ofertuesit duhet të përmbushin kriteret minimale në vijim:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive të Republikës së Maqedonisë për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike;
- të ketë në mënyrë të suksesshme të realizuara së paku 3 ekskursione për nxënës djhe aktivitetet tjera të lira në 3 vite e fundit;
- përmbushë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.

Në ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes për realizim të ekskursioneve, ofertuesi i përzgjedhur të parashtrorë garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit në shumë prej 5% të çmimit të përgjithshëm të marrëveshjes.

Ofertat të parashtrohen në adresën SHFK "Shën Kliment Ohridski" Dellçevë rr. "M. M Brico" pn, Dellçevë me shenjë (Komisioni për grumbullimin e ekskursioneve).

Kriteri për parashtrimin e marrëveshjes: Çmimi më i ulët

Ofertat e pakompletuara dhe të vonuara nuk do të shqyrtohen.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Komisioni për realizimin e ekskursioneve pranë SHFK "Shën Kliment Ohridski" Dellçevë

PORTIERI BELG "TRADHTON" ÇELLSIN

KURTOA TAKOHET ME DREJTUESIT E PSZH-së?

Të tilla dyshime u ngritën kur stacioni televiziv belg "RTBF" pretendoi se portieri 25-vjeçar dhe babai i tij, Thierry u takuan të hënën me përfaqësues të PSZH-së, për bisedime jozyrtare. Por, menaxheri i Kurtoa, Kristof Henrotaj insiston se një takim i tillë nuk ka ndodhur, që supozohej të ishte pa dijeninë e Çellsit


Ishte parashikuar që Kurtoa të ulej muajin e kaluar me drejtuesit e Çellsit, për të nënshkruar një kontratë të re afatgjatë, me klubin nga "Stamford Bridge" që i frikësohet interesimit të Real Madridit. Por, "Sun Sport" raporton se nuk u zhvillua asnjë takim dhe nuk do të mbahet asnjë i tillë deri në përfundim të këtij sezoni, duke ndezur dyshime të reja në lidhje me të ardhmen e tij te Çellsit. Të tilla dyshime u ngritën kur stacioni televiziv belg "RTBF" pretendoi se portieri 25-vjeçar dhe babai i tij, Thierry u takuan të hënën me përfaqësues të PSZH-së, për bisedime jozyrtare. Por, menaxheri i Kurtoa, Kristof Henrotaj insiston se një takim i tillë nuk ka ndodhur, që supozohej të ishte pa dijeninë e Çellsit. "Unë nuk kam dëgjuar kurrë për atë takim. Nëse ndonjë klub është i interesuar, ata e dinë se çfarë duhet të



bëjnë, të gjejnë një marrëveshje me Çellsin dhe më pas të flasin me mua, për të parë rreth interesimit të klientit tim. 'RTBF' është një televizion i vogël belg dhe ndonjëherë pëlqejnë histori pikante për tu mbajtur gjallë. Por informacioni i tyre nuk është korrekt", deklaroi menaxheri Henrotaj. Kurtoa pu-

non ngushtësisht me menaxherin e tij Henrotaj, ndaj është e pamundur që të jetë zhvilluar ndonjë takim pa prezencën e biznesmenit. Në fakt, Henrotaj ka qenë në Kinë që javën e kaluar, për të realizuar marrëveshjen tashmë të zyrtarizuar që finalizoi transferimin e yllit të Atletico Madrid Karrasko te Da-

lian jifang, për shumën e 26 milionë eurove. Kurtoa është nën kontratë me Çellsin deri në fund të sezonit të ardhshëm, por deri tani ka shfaqur qëllimin për të dëshmuar besnikëri afatgjatë në "Stamford Bridge". Ndërkohë, Real Madridi ka bërë gati ofertën prej 50 milionë euro për merkaton e verës.



Juventus ringjall interesimin për Belerinin

Juventus do të ringjallë këtë verë interesin e tyre në mbrojtësin e djathtë të Arsenalit, Hektor Belerin. Belerin ishte i lidhur me Juve në secilën prej dy dritareve të fundit të transferimeve, por një kalim nuk u materializua. Kështu, pas dështimeve të njëpasnjëshme u raportua se "zonja e vjetër" ka hequr dorë nga shërbimet e spanjollit. Sipas mediumit britanik "The Guardian", Bianconerët priten të gjykojnë lojtarin e Arsenalit për të tretën herë. Megjithatë, gazeta paralajmëron se vetëm një ofertë në rajonin e 50 milionë eurosh do të jetë e mjaftueshme për të bindur Arsenalin për largimin e lojtarit. Përveç mbrojtësit si 'prioritet' nënshkrimi për Juve, "The Guardian" vëren se spanjolli është i zhgënjyer me hapat mbrapa të Topçinjeve kohëve të fundit. 22-vjeçari është përmendur gjithashtu si një objektivi i mundshëm për Barcelonën, ku ai filloi karrierën e tij. Belerin këtë sezon nuk është në formën më të mirë, por talenti i tij nuk mungon dhe ndër vite ka bartur rol të rëndësishëm te Arsenalit.


Largohet vetëm nëse vjen oferta nga Reali



Eden Hazard do të bërë të ditur kohët e fundit se është gati të rinovojë kontratën e tij në me Çellsin. Marrëveshja

aktuale e belgut në "Stamford Bridge" përfundon në verën e vitit 2019 dhe londinezët po bëjnë të pamundurën për ta mbajtur më tej në skuadër futbollistin e tyre simbol, duke e larguar nga kthevat e skuadrave më të mëdha në Evropë. Gjithsesi, sipas shtypit spanjoll, Hazard është i gatshëm ta rinovojë kontratën me një kusht, që klubi ta lërë të lirë të largohet nëse vjen oferta e duhur nga Real Madridi. Në fillim të muajit, babai i tij, Thierry Hazard, deklaroi. "Eden nuk ka rinovuar ende me Çellsin sepse është në dijeni të interesimit të Real Madridit dhe ëndërron që të luajë për këtë klub". Pra, me fjalë të tjera nëse Reali e kërkon, 27-vjeçari është i gatshëm të shkojë në "Santiago Bernabeu", përndryshe do të rinovojë bashkëpunimin me Çellsin. Kjo është ajo që është shkruar sot në faqet me "El Mundo Deportivo".

Liverpuli interesohet për Leminan



Liverpuli duket se do të marrë një tjetër futbollist nga Sautemptoni, pasi trajneri Jurgen Klopp është i interesuar për të marrë Mario Lemina gjatë verës së ardhshme. "Të kuqtë" kanë marrë gjashtë futbollistë nga Sautemptoni, që nga qershori i vitit 2014: Riki Lambert, Adam Lallana, Dejan Lovren, Klyne, Sadio Mane dhe Virgil van Dijk. Verën e kaluar, Liverpuli arriti marrëveshjen me RB Leipzig për të marrë Naby Keita, i cili do t'i bashkohet "të kuqve" vetëm në verën e ardhshme dhe do të marrë vendin Emre Xhan, që do të largohet në fund të kontratës. Gjithsesi, gazeta franceze "L'Equipe" ka shkruar se Liverpuli ka nisur bisedimet me mesfushorin e kombëtares së Gabonit, Lemina. Gjithsesi, Klopp ka në dispozicion edhe mesfushorë të tjerë si Vijnaldum, Milner, Lallana, Henderson dhe Çaamberlain që ka ardhur nga Arsenalit, por gjithashtu është rritur në akademinë e Sautempton. Lemina ka lënë një përshtypje shumë të

mirë te Sautemptoni, që kur u morr për 20 milionë nga Juventusit në verën e vitit të kaluar dhe ka një kontratë deri në vitin 2022 me "shenjtorët", të cilët pretendojnë 40 milionë euro për ta lënë të lirë.

NEJMAR DO TË KETË NJË KAT TË SPITALIT VETËM PËR VETE



Lojtari do të shoqërohet nga mjeku i Brazilit, doktor Rodrigo Lasmar dhe Gerard Salliant, doktori që ka operuar Ronaldo Nazaron pas dëmtimit të tij në gju në vitin 2000, ashtu si edhe drejtori sportiv i PSZH, Maksvell

ashtu si edhe drejtori sportiv i PSZH, Maksvell. Neymar ka zbankuar në Rio de Zhaneiro të enjten në një karrige me rrota dhe më pas ka marrë një avion privat për të shkuar në rezidencën e tij në Mangaritiba. Shtypi vendas ka bërë të ditur se Maksvell dhe Asilant do të shkojnë në Brazil të premten, të njëjtën ditë që ish-lojtari i Barcelonas duhet të shkojë në Belo Horizonte. Lasmar ka thënë për "Globo" se Neymar

duhet të dalë nga spitali din pas operacionit, edhe pse nuk dihet akoma me siguri nëse ai do të kthehet në Paris për të vazhduar rikuperimin e tij apo do ta bëjë një gjë të tillë në Brazil. Doktori brazilian ka parashikuar se periudha e tij e rikuperimit do të jetë rreth 3 muaj, me lojtarin që nuk do të mundësi të luaj deri në fundin e majit, rreth tri javë para se Brazili të luajë në Kupën e Botës kundër Zvicrës.



Më mungon Kombëtarja

Në qershor të vitit 2016 kishte njoftuar lamtumirën e tij nga përfaqësuesja suedeze, por tani Zlatan Ibrahimoviç nuk e përjashton një rikthim të bujshëm në vigjilje të Botërorit "Rusi 2018". "Më mungon Kombëtarja. Nuk besoj se ndonjëri duhet të më thërrasë. Nëse dua të kthehem, atëherë e bëj. Në të vërtetë, porta nuk është e mbyllur për asgjë në realitet, kur ke luajtur për 20 vite në ekipin përfaqësues dhe nuk je më, por sheh të tjerët që luajnë, atëherë është e vështirë", deklaroi Ibra për "SportExpressen". "Nuk dua të vij vetëm sepse jam dikushi. Por nuk mund të përqendrohem te skuadra përfaqësuese nëse nuk luan, njerëzit po flasin, ndërkohë që unë nuk jam te lista", tha Zlatan Ibrahimoviç, prezent në Stokholm, për promovimin e një qendre të re sportive. Një eveniment ku ishte prezent edhe shoku i tij i ekipit, Paul Pogba, që shtoi: "Zlatan është plot me surpriza, kështu që nuk e di kurrë, nëse do të luajë ose jo në Botëror", thotë Pogba.

Mungesa e Italisë, më e madhja në historinë e Botërorëve!

Legjenda e Argjentinës, Diego Armando Maradonas, e ka cilësuar dështimin e Italisë në eliminatoret e Kupës së Botës si "një nga mungesat më të mëdha" në historinë e futbollit ndërkombëtar. Katër herë kampionët e botës nuk arritën të marrin një vend në fazën finale, që do të zhvillohet verën e ardhshme në Rusi, pasi u eliminuan nga Suedia në "play off", me rezultatin e përgjithshëm 1-0. Kanë kaluar 60 vjet nga hera e fundit që Italia nuk ka luajtur në një kampionat botëror. "Më vjen shumë keq që Italia

nuk do të jetë në Kupën e Botës. Italianët e bëjnë shumë tërheqëse këtë veprimtari dhe mendoj se kjo është një nga mungesat më të mëdha në historinë e kampionateve botërore", – u shpreh Maradona. – E pashë ndeshjen e "play off" në nëntor. Italia luajti ashtu si donte Suedia, me krosime. Suedezët kishin qendërmbrojtës gjigantë. Është shumë e trishtë që nuk do e shohim Italinë në Rusi. Kjo tregon se eliminatoret po bëhen gjithnjë e më të vështira", deklaroi legjenda e Argjentinës.



Barcelona i ofron mbështetje financiare heroit të Floridas

Barcelona i ka ofruar mbështetje shëndetësore Antony Borges dhe do t'i jap djaloshit të ri shansin për të takuar Lionel Messin pas aktit heroik që bëri gjatë tragjedisë së ndodhur në një shkollë në Florida, dy javë më parë. Më 14 shtator, 14 nxënës dhe 3 mësues u vranë në "Marjory Stoneman Douglas High School" në Parkland. Ish-nxënësi, Nikolas Kruz, ka qenë fajtor për këto 17 viktima me parameditim. Borges, 15 vjeç mori pesë plumba në kurriz në momentin që qëndroi në mënyrë heroike para derës së shkollës për të mbrojtur të tjerët nga breshëria e plumbave. Borges, luftoi për dy ditë për mbijetesë,

por tani gjendja e tij është stabilizuar edhe pse rrezikon të mbetet i paralizuar. Ai ka qenë për dy muaj pjesëtar i Akademisë së Barcelonës në Lauderdale, pranë Fort Lauderdale, në vitin 2016. Sapo e mësuan diçka të tillë drejtuesit e klubit katalanas vendosën të mbulojnë të gjitha shpenzimet financiare për kurën shëndetësore që do të ndjek adoleshenti dhe u lidhën me babanë e tij Rojer Borges për t'i dhënë këtë suport. Ishte gazetari Santiago Seguro-la që zbuloi se 15-vjeçari ishte tifoz i Barçës dhe klubi vendosi për këtë gjest humanitar karshi heroit të vogël.



HIS NAME IS ANTHONY BORGES AND HE IS 15 YEARS OLD.

TELEFONI I DEDIKUAR VETËM PËR FËMIJËT

Fëmijët dita-ditës po bëhen më të varur nga telefonat e mençur. Për këtë arsye një kompani spanjolle nën emrin "Escudo Web" ka krijuar një telefon të mençur të dedikuar vetëm për fëmijë. I njohur si "PhoneKid", pajisja ia mundëson prindërve t'ua kontrollojnë telefonin përmes një aplikacioni. Në këtë mënyrë fëmijët nuk do të mund të kyçen kudo dhe do të monitorohen lehtë nga prindërit. Pajisja po ashtu nuk mund të fiket kurrë dhe ka ehe një buton emergjent për të thirrur prindërit. "PhoneKid" ka një version special të Androidit.



51 vjeçarja rreh të dashurin pasi ai ndërpreu aktin seksual për të gatuar



Një grua në Florida, SHBA është arrestuar, pasi u akuzua se ka rrahur të dashurin e saj, kur ai ndërpreu aktin seksual për të parë darkën që kishte lënë në zjarr. Teresa Warren, 51 vjeç, u arrestua pasi policët morën një telefonatë për dhunë në familje. Sipas Daily Mail, ajo tha për policinë se ajo dhe i dashuri i saj po pinin alkool dhe po bënin qejf kur ai e goditi papritur në fytyrë. Por i dashuri i saj kishte një tjetër version. Ai tha se çifti po pinte alkool dhe po gatuanin. Megjithatë, ata filluan të kryenin marrëdhënie seksuale kur ai u kujtua që po gatuante dhe shkoi të sigurohej që ushqimi mos të digjej. Në atë moment Warren përplas një televizor në dyshe. Pasi i dashuri i saj e pyet ku qëndronte problemi, ajo filloi ta godiste atë me një grusht në fytyrë, kokë, bark dhe këmbë. Ai arriti ta shtyjë atë dhe i tha të largohej. Por Warren e ndoqi prapë për ta goditur dhe në atë moment i dashuri i saj e mbërthen me duar për ta ndaluar. I dashuri i saj mbeti me njërin sy të ënjtur dhe me plagë në bark.

Konsumimi i arrave ndihmon ndaj kancerit të zorrëve



Pacientët me kancer të zorrëve mund të shtojnë gjasat për mbijetesë duke konsumuar arra, thotë një studim i ri. Konsumimi i arrave çdo javë shton gjasat për t'iu shmangur sëmundjes për 57 për qind, në krahasim me ata që nuk i konsumojnë. Ekspertët pranë Qendrës Yale Cancer thonë se po ashtu konsumimi i bajameve, lajthive

luajnë rol pozitiv në këtë aspekt.

Temidayo Fadelu sugjeron se konsumimi i arrave ndihmon në mposhtjen e kancerit duke i bërë pacientët më pak rezistent ndaj insulinës - gjë që çon në më pak sheqer në gjak. Më shumë se 40.000 njerëz diagnostifikohen me kancer në zorrë çdo vit në Britani të Madhe.



Monedhat virtuale po vrasin njerëz

Një nga njerëzit më të pasur në botë, Bill Gates është kundër monedhave virtuale. Gates shprehet se këto monedha, si Bitcoin tërthorazi po vrasin njerëz. Ai e shprehu këtë mendim të tijin përmes rrjetit Reddit. "Për momentin, të ashtuquajturat kriptomonedha po përdoren masivisht për të blerë fentanil dhe drogëra të tjera. Pra, bën pjesë tek teknologjia që po vret njerëz", thotë Bill Gates. Megjithatë,

ky vlerësim i tij nuk kaloi pa u kritikuar. Shumë përdorues iu vërsulën duke e quajtur "të paditur" dhe "të painformuar" në lidhje me monedhat virtuale dhe i kërkuan që të mos komentojë më këto monedha pa marrë më parë informacionin e duhur. Gates nuk është i pari që kritikon monedhat virtuale, por është i pari që i lidh këto monedha me kriminalitetin.

1409 - Përfundon Lufta Civile në Austri.

1837 - Kryetari amerikan Andrew Jackson dhe Kongresi njohin Republikën e Teksasit.

1845 - Florida bëhet shteti i 27 i SHBA-ve.

1857 - Lufta e Dytë e Opiumit: Franca dhe Britania e Madhe i shpallin luftë Kinës.

1861 - Cari rus Aleksandri II shfuqizon ligjin për robëri.

1863 - Abraham Lincoln miraton të drejtën për themelimin e Akademisë Nationale të Shkencave.

1869 - Universiteti i Karolinës Jugore hapet për të gjitha racat.

1878 - Bullgaria lirohet nga Turqia (Traktati i Shën Stefanit).

1917 - Cari i fundit rus Nikolla II jep dorëheqje.

1919 - Partia Komuniste në Gjermani paralajmëron grevë të përgjithshme.

1922 - Fashitet italian okupojnë Fiumin dhe Rijekën.

1955 - Elvis Presley bën shfaqjen e tij të parë televizive.

1968 - Ambasadat e Greqisë, Portugalisë dhe Spanjës bombardohen në Hagë.

1978 - Vidhen eshtrat e Çarli Çaplin-it në Zvicër.

KALENDARI HISTORIK 3 MARS



Arabëve prodhimi i një fuçie naftë u kushton vetëm 2 dollarë dhe e she-sin rreth 130 dollarë. "Saudi Aramco", kompania kombëtare e naftës në Arabinë Saudite fiton rreth 200 miliardë dollarë neto në vit.



Peshkaqenët nuk së-muren kurrë. Ata janë imunë ndaj çdo sëmundjeje, madje edhe ndaj kancerit.

Që nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës, asnjë Qeveri nuk ka arritur të përfundojë mandatin qeverisës deri në fund. Të gjitha janë shpërbërë parakohe.



50 EURO

Dy polic duke ecur rrugës, njeri polic shef 50 euro.

- Wow 50€! E sheh mirë e mirë e pastaj e gris...

Polici tjetër e shikon e pyet:

- Pse e gris?!?

- Ishte fals!

- Nga e kuptove?

- Ke parë ndonjëherë 50 euro me dy zero ti?



Dashuria është eksperiencia më e pasur, që një qenie njerëzore mund të përjetojë!

(Mario Vargas Llosa)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS